# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6115
E mërkurë, 16 shtator 2020
çmimi 0.40 €

## Trumpi: Hoti dhe Vuçiqi e bënë Ballkanin dhe botën më të sigurt FAQE 2



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

NJOHËSIT E RRETHANAVE POLITIKE NË VEND KANË KRITIKUAR PROCESIN E DIALOGUT NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË NË BRUKSEL FAQE 4-5

# ANALISTËT: DIALOGU I BRUKSELIT, JOTRANSPARENT

Procesi i dialogut për normalizim të marrëdhënieve Kosovë - Serbi në Bruksel është kritikuar për mostransparencë. Njohësit e rrethanave politike në vend kanë vlerësuar për gazetën "Epoka e re" se ky proces po karakterizohet me një terr informativ. Imer Musholaj dhe Violeta Haxholli kanë deklaruar se kryeministri Avdullah Hoti duhet të ofrojë informacione më të shumta për Kuvendin e Kosovës dhe publikun për këtë proces të rëndësishëm për Republikën e Kosovës

# I jepet lamtumira e fundit aktorit Adem Mikullovci



Të martën në varrezat e qytetit në Dragodan (Arbëri) i është dhënë lamtumira e fundit aktorit dhe politikanit Adem Mikullovci. Në ceremoninë mortore morën pjesë familjarë, përfaqësues të komunitetit artistik dhe përfaqësues të institucioneve të vendit. Bashkëshortja e tij, Lumnije Mikullovci, tha se Ademi ka jetuar me teatër dhe film. Ndërkaq përfaqësues të institucioneve dhe përfaqësues të komunitetit artistik kanë vlerësuar se Adem Mikullovci do të jetë i paharruar në mesin tonë me shpirtin e madh fisnik dhe artistik dhe me trashëgiminë e pashterur artistike që ka lënë pas FAQE 6

## OSMANI: LEGJITIMITETI, PËRGATITJA DHE ARRITJA E UNITETIT POLITIK JANË FORMULA E VETME PËR SUKSES NË DIALOG

FAQE 3

## OPINION

### SABIT BROKAJ, NJË JETË NË SHËRBIM TË KOMBIT DHE ATDHEUT, DERI NË PËRJETËSI! F. 11

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



## AKTUALE

### NJË I VDEKUR DHE 71 RASTE TË REJA ME KORONAVIRUS F. 3

### DEMOKRACIA NË KOHË PANDEMIE F. 8

## EKONOMI

### ABRASHI: PROJEKTET ME VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR LEHTËSOJNË LËVIZJEN E NJERËZVE DHE TË MALLRAVE F. 9

### PRODHUESIT E QUMËSHTIT TAKOHEN ME KRYEMINISTRIN, KËRKOJNË PËRKRAHJE NGA QEVERIA F. 9



## KULTURË

### MKRS-JA DHE UP-ja NËNSHKRUAJNË MEMORANDUM PËR BURSA STUDIMI PËR TRASHËGIMINË KULTURORE F. 6

## SPORT

### REXHA: MUND TA ELIMINOJMË SILEKSIN F. 16

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

# Trumpi: Hoti dhe Vuçiqi e bënë Ballkanin dhe botën më të sigurt

PRISHTINË, 15 SHTATOR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, tha se marrëveshja për normalizimin e marrëdhënieve ekonomike midis Kosovës dhe Serbisë do t'i bëjë këto dy vende, ashtu si edhe Ballkanin dhe botën, më të sigurta.
Një hap i tillë ka kërkuar guximin e jashtëzakonshëm të udhëheqësve, tha Trump, transmeton Departamenti Amerikan i Shtetit në llogarinë e vet në "Instagram".
Trump citohet të ketë thënë se "guximi i jashtëzakonshëm" i presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, dhe i kryeministrit të Kosovës, Avdullah Hoti, ka qenë i nevojshëm për t'i nisur këto bisedime dhe "për të ardhur në Uashington, për t'i finalizuar detyrimet". "Duke e bërë këtë, ata i kanë bërë vendet e tyre, Ballkanin dhe botën, më të sigurt", ka thënë Trump.
Hoti dhe Vuçiqi kanë nënshkruar marrëveshjen për normalizimin e marrëdhënieve ekonomike më 4 shtator në Shtëpinë e Bardhë, në praninë e presidentit Trump.
Të dyja palët, megjithatë, nuk i kanë hedhur nënshkrimet në dokumentin e njëjtë, por secila veç e veç i ka nënshkruar zotimet e saj.
Trump, në anën tjetër, ka nënshkruar një letër, përmes së cilës i ka përgëzuar palët për guxim drejt normalizimit të marrëdhënieve.



## GRENELLI: TRUMPI DO TA VIZITOJË KOSOVËN

Emisari special amerikan për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell, ka thënë se presidenti Donald Trump mund ta vizitojë shumë shpejt Kosovën dhe rajonin.
Në një intervistë për një radio në gjuhën serbe në Chicago, ai ka thënë se ende nuk është vendosur ndonjë datë për këtë vizitë, por ka pajtime për një gjë të tillë. "Unë personalisht e kam inkurajuar presidentin Trump që t'i vizitojë Kosovën, Serbinë dhe tërë rajonin dhe ta shoh fuqinë e ekonomisë se sa është e zhvilluar atje. Presidenti Trump ka thënë se mezi pret që të shkojë, por nuk kemi dataëapo ndonjë afat kohor në mendje. Pengesa e parë që të kthehet fokusi në Shtëpinë e Bardhë për të bërë një gjë të tillë është tejkaluar. Ne duam ta bëjmë. Vetëm duhet të punojmë që të gjejmë kohë që do të ishte e përshtatshme për Shtëpinë e Bardhë dhe Këshillin Kombëtar të Sigurisë, të cilët do të përfshihen në këtë për së afërmi. Ne mezi presim dhe jemi të fokusuar në këtë", ka thënë Grenelli.

# Gjermania pritet të pranojë 1 500 refugjatë nga ishujt grekë

BERLIN, 15 SHTATOR - Gjermania planifikon të ofrojë strehim për 1 500 migrantë që aktualisht janë në ishujt grekë, kanë thënë disa burime qeveritare për agjencinë e lajmeve AFP, ndërkohë që çështja e ndjeshme e migrantëve është përfshirë sërish në agjendën politike të Bashkimit Evropian, pasi një zjarr ka shkatërruar një kamp të stërngarkuar të migrantëve në ishullin grek Lesbos.
Rreth 12 000 ish-banorë të kampit Moria në Greqi janë duke jetuar aktualisht në ndërtesa të braktisura, apo rrugë, pasi kampi është shkatërruar më 8 shtator. Teksa rritet presioni ndaj bllokut evropian për ta bërë punën e tij, Berlini veçse i është bashkuar iniciativës evropiane për të strehuar 400 fëmijë të pashoqëruar të këtij kampi.



Mirëpo, përveç 150 fëmijëve të tjerë, Gjermania planifikon t'i mirëpresë familjet me fëmijë që tashmë kanë siguruar statusin e refugjatit dhe mund të mos jenë nga kampi Moria, është cituar një plan i miratuar nga kancelarja gjermane Angela Merkel dhe ministri i Brendshëm gjerman, Horst Seehofer.
Ky plan është thënë të jetë krijuar pasi qytetet gjermane i kanë bërë thirrje Berlinit që të bëjë më shumë.
Qeveria e Merkelit ka insistuar se duhet të gjendet një zgjidhje evropiane për këtë çështje në vend të individualitetit.
Shefi i Këshillit Evropian, Charles Michel, ka thënë në Athinë, teksa ka takuar kryeministrin Kyriakos Mitsotakis, se BE-ja duhet të ofrojë "përgjigje të fuqishme dhe efikase" për problemin e migrimit.
Greqia është duke rritur përpjekjet për të krijuar strehim të përkohshëm, ndërkohë që banorët lokalë janë duke u përgatitur për mbajtje të protestave kundër migrimit.
Të martën ministria greke për Migrim ka thënë se rreth 800 banorë të kampit Moria janë strehuar në vendbanime të përkohshme në Lesbos. Prej tyre, 21 kanë rezultuar pozitivë në testet për koronavirus, ka thënë kjo ministri.

# Senatorët amerikanë paraqesin rezolutë për sanksionimin e zyrtarëve bjellorusë

MINSK, 15 SHTATOR - Një grup prej 13 senatorësh amerikanë, republikanë dhe demokratë, paraqiti një rezolutë që bën thirrje për sanksione kundër zyrtarëve të Bjellorusisë, të cilët janë përgjegjës për shtypjen brutale të protestave paqësore në këtë vend. Senatori republikan Jim Risch, kryetar i Komitetit të Senatit për Marrëdhënie me Jashtë, tha se dhuna dhe shtypja e vazhdueshme e opozitës në Bjellorusi "janë të papranueshme". Rezoluta thotë se zgjedhjet e 9 gushtit, të cilat i kanë dhënë presidentit bjellorus Alyaksandr Lukashenka, edhe një mandat 6-vjeçar, "nuk kanë qenë as të lira, as të drejta" dhe rezultatet e shpallura nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i konsideron të pavlefshme.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Një i vdekur dhe 71 raste të reja me koronavirus

Në 24 orët e fundit ka rënë numri i vdekjeve nga Covid-19 në Kosovë. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se në 24 orët e fundit ka ndërruar jetë vetëm një person nga koronavirusi në vend, janë shënuar 71 raste të reja të infektimit dhe janë shëruar 199 pacientë




EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 15 SHTATOR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se në 24 orët e fundit ka ndërruar jetë vetëm një person nga Covid-19 në Kosovë.

IKShPK-ja ka treguar se gjatë kësaj periudhe kohore janë shënuar 71 raste të reja me koronavirus. "Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK dhe në laboratorët privatë me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 608 mostra të marra nga ShSKUK dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 71 raste pozitive. Brenda 24 orëve është raportuar 1 rast i vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv", ka njoftuar IKShPK-ja, duke e treguar numrin total të rasteve. "Numri total i rasteve pozitive është 14 763 raste nga 59 033 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 601 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 199 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 11 784 raste, kurse numri i rasteve aktive është 2 378", është thënë në njoftimin për medie. Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 20 raste, komuna Skenderaj 6 raste, komuna Ferizaj 4 raste, komuna Gjilan 4 raste, komuna Pejë 4 raste, komuna Vushtrri 4 raste, komuna Klinë 3 raste, komuna Lipjan 3 raste, komuna Prizren 3 raste, komuna Drenas 2 raste, komuna Fushë Kosovë 2 raste, komuna Gjakovë 2 raste, komuna Kamenicë 2 raste, komuna Mitrovicë 2 raste, komuna Obiliq 2 raste, komuna Podujevë 2 raste, komuna Viti 2 raste dhe me nga një rast komunat Deçan, Malishevë, Shtime dhe Suharekë.

### Zemaj i shqetësuar për neglizhencën e masave anit Covid në disa shkolla

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, është shprehur i shqetësuar që disa shkolla në ditën e hapjes së vitit të ri shkollor janë treguar të pakujdesshme për respektimin e masave anti Covid. Në profilin e vet në "Facebook", ai ka shkruar se është punuar shumë që lakorja e të infektuarve me Covid të bjerë. "Në ditën e parë të vitit të ri shkollor në Kosovë u raportuan vetëm 55 raste të reja pozitive. Është punuar shumë që kjo lakore e infektimeve të ulet dhe shtatori të na gjejë në një ambient më të sigurt. Dje isha për vizitë në dy shkolla në Komunën e Prishtinës dhe të Vushtrrisë për t'i parë përgatitjet për mësim. Por, janë për keqardhje pamjet e publikuara nga disa shkolla të tjera për neglizhencën e masave nga disa prindër dhe arsimtarë, të grumbulluar para dyerve të shkollave, pa maskat mbrojtëse", ka shkruar ai.

Zemaj ka ftuar personelin arsimor të tregohet i përgjegjshëm dhe me përpikëri të vazhdojë t'i respektojë masat. "Lus prindërit dhe personelin arsimor të tregohen të përgjegjshëm dhe me përpikëri të vazhdojnë t'i respektojnë masat. Çdo neglizhencë e rekomandimeve antiCovid rrezikon shëndetin e përgjithshëm dhe nuk do të tolerohet. Ne do ta vazhdojmë angazhimin që të respektohen masat antiCovid dhe të ruhet shëndeti i fëmijëve dhe nxënësve. Vetëm bashkë mund t'ia dalim!", ka shkruar Zemaj.

# Osmani: Legjitimiteti, përgatitja dhe arritja e unitetit politik janë formula e vetme për sukses në dialog



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 15 SHTATOR - Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka zhvilluar të martën një takim me përfaqësuesin special të Norvegjisë, Arne Sannes Bjornstad. Në takim janë trajtuar çështje të ndryshme të bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve, me theks të veçantë në bashkëpunimin ndërparlamentar dhe menaxhimin e situatës me pandeminë Covid-19.

Kryetarja Osmani e ka falënderuar Bjornstadin për ndihmën dhe përkrahjen e dhënë nga ana e shtetit të Norvegjisë në menaxhimin e pandemisë. Ata, gjithashtu, kanë diskutuar për efektet e menjëhershme pozitive pas hyrjes në fuqi të Ligjit për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19, duke ndikuar drejtpërdrejt në përmirësim të situatës dhe rrjedhimisht duke zvogëluar numrin e rasteve të infektuara. Theks të veçantë në takim është vënë mbi zhvillimet aktuale politike në vend, veçanërisht në procesin e dialogut.

Kryetarja Osmani e ka potencuar si të domosdoshme nevojën për transparencë të plotë përgjatë tërë këtij procesi, e sidomos respektimin e zotimeve të dhëna para Kuvendit dhe qytetarëve të Kosovës. Sipas Osmanit, nuk ka alternativë tjetër përpos dialogut, mirëpo është gabim serioz që po hapen çështje tashmë të mbyllura ndër vite si dhe po diskutohen çështje të rregullimit të brendshëm që tashmë janë shpallur jokushtetuese nga Gjykata Kushtetuese në vend.

Në këtë drejtim, Osmani theksoi se: "Legjitimiteti, përgatitja, përvoja dhe arritja e unitetit politik janë formula e vetme për sukses në dialog". Të dyja palët u pajtuan që është tejet e rëndësishme që tërë ky proces të kalojë përmes Kuvendit dhe të sigurohet që Kuvendi të ketë rol aktiv.

NJOHËSIT E RRETHANAVE POLITIKE NË VEND KANË KRITIKUAR PROCESIN E DIALOGUT NË MES TË KOSOVËS I

# ANALISTËT: DIALOGU I BRU

Procesi i dialogut për normalizim të marrëdhënieve Kosovë - Serbi në Bruksel është kritikuar për mostransparencë. Njohësit e rrethanave politike në vend kanë vlerësuar për gazetën "Epoka e re" se ky proces po karakterizohet me një terr informativ. Imer Musholaj dhe Violeta Haxholli kanë deklaruar se kryeministri Avdullah Hoti duhet të ofrojë informacione më të shumta për Kuvendin e Kosovës dhe publikun për këtë proces të rëndësishëm për Republikën e Kosovës



EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 15 SHTATOR - Njohësit e rrethanave politike në vend e kanë kritikuar procesin e dialogut të Brukselit për normalizim të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë për mostransparencë. Ata kanë vlerësuar se kryeministri Avdullah Hoti duhet të ofrojë më shumë informacione për Kuvendin e Kosovës dhe publikun e gjerë për këtë proces.

Analisti politik Imer Musholaj ka deklaruar për gazetën "Epoka e re" se ndryshe nga procesi i Uashingtonit, ku është ditur se çka do të bisedohet, procesi i Brukselit po karakterizohet me mostransparencë të madhe. "Për fat të keq, procesi i Brukselit tani është duke u karakterizuar me një jotransparencë shumë të madhe. Ndryshe prej procesit të Uashingtoni që në njëfarë forme ka qenë e ditur se për çka po bëhet fjalë apo se cilat do të jenë temat, tash në procesin e Brukselit është një mostransparencë jashtëzakonisht e madhe. Unë besoj se Hoti duhet ta gjejë mënyrën që publikut t'ia bëjë të qartë se për çfarë po diskuton në Bruksel", ka thënë Musholaj. Ai ka bërë me dije se kryeministri paraprakisht duhet të tregojë se çka do të bisedojë në Bruksel me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. "Është e domosdoshme që të sqarohen paraprakisht temat që do të diskutohen, sepse është jashtëzakonisht e frikshme që ai të thotë se do të diskutohet për asociacionin , ndërkohë që nuk dihet se për cilin version të asociacionit bëhet fjalë, për atë që është nënshkruar në Bruksel, apo për atë që e ka vlerësuar Gjykata Kushtetuese si jokushtetuese", ka deklaruar Mushkolaj.

Edhe Violeta Haxholli, hulumtuese në KDI, ka vlerësuar se kryeministri Avdullah Hoti ka ofruar vetëm informacione sipërfaqësore për këtë proces. "Fatkeqësisht, edhe pse kryeministri ka raportuar edhe më herët në Kuvend lidhur me këtë temë, raportimet e tij kanë qenë shumë sipërfaqësore dhe ai është rezervuar për të ofruar informacione konkrete lidhur me zhvillimet në dialog, duke e bërë këtë fazë të dialogut shumë jotransparente për Kuvendin dhe publikun e gjerë", ka deklaruar Haxholli. Sipas saj, duhet të dihet më shumë për temat që diskutohen dhe kërkesat e Kosovës në këtë proces. "Do të ishte mirë që në raportimin e radhës kryeministri të ofrojë të dhëna më konkrete lidhur me agjendën dhe temat e diskutimit në Bruksel si dhe kërkesat e Kosovës në këto takime", ka deklaruar Haxholli.

### Kosova shkoi në Uashington pa platformë

Analisti Imer Mushkolaj ka deklaruar se delegacioni i Kosovës ka shkuar në takimin e Uashingtonit pa platformë për dialog. Sipas tij, kjo ka bërë që pastaj marrëveshja e nënshkruar në Shtëpinë e Bardhë më 4 shtator të interpretohet në mënyra të ndryshme. "Së pari, delegacioni i Kosovës para se të nisej në Uashington është dashur ta ketë një platformë të qartë. Fatkeqësisht, delegacioni i Kosovës, i udhëhequr nga kryeministri Hoti, nuk ka pasur platformë të qartë, sepse mungesa e platformës pastaj ka bërë që zotimet që janë nënshkruar në njëfarë forme të interpretohen ndryshe, varësisht prej perspektivës së partive në pushtet apo partive opozitare", ka deklaruar Mushkolaj. Sipas tij, opinioni publik nuk e di nëse është negociuar në këtë takim. "Marrëveshja është bërë transparente pasi është nënshkruar, mirëpo ne nuk e



# Veseli me kryetarët e degëve të PDK-së diskuton për situatën politike në vend

PRISHTINË, 15 SHTATOR (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike i Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka takuar në Prishtinë kryetarët e degëve të PDK-së. PDK-ja përmes një njoftimi për media ka njoftuar se Veseli dhe kryetarët e degëve kanë diskutuar për situatën politike nëpër të cilën po kalon vendi, për sfidat me pandeminë dhe për nevojën e një mobilizimi edhe më të madh në të mirë të qytetarëve të Republikës së Kosovës. "Partia Demokratike e Kosovës, sikur gjithmonë, edhe në këto momente sfiduese për vendin do ta vendosë interesin shtetëror para çfarëdo interesi tjetër politik dhe ditor", ka njoftuar PDK-ja.

Veseli që disa ditë ka vizituar degët e partisë në nivel vendi, ku ka kërkuar mobilizim dhe fuqizim të PDK-së.

DHE SERBISË NË BRUKSEL

# KSELIT, JOTRANSPARENT




dimë nëse ndërkohë janë negociuar të gjitha ato pika të cilat janë nënshkruar. Është e natyrshme që delegacionet, edhe delegacioni i Kosovës të thotë se ka pasur negociata. Unë dyshoj se ka pasur negociata të thella në këtë takim", ka deklaruar ai, duke shprehur skepticizëm se ka pasur negociata të mirëfillta për arritjen e marrëveshjes së Uashingtonit. "Besoj se këto zotime kanë qenë në letër paraprakisht dhe palët vetëm i kanë konsumuar si të tilla. Pra, nuk ka pasur negociata në kuptimin klasik të fjalës. Këto përplasjet e brendshme të Kosovës kanë sjellë situatën që Hoti të shkojë atje me atë premtimin se nuk do të negociohet asgjë përpos njohjes reciproke, që doli të jetë një blof i tij i madh", ka vlerësuar ai.

Kurse Violeta Haxholli nga KDI-ja ka deklaruar se kryeministri ka për obligim kushtetues të raportojë në Kuvend për të gjitha takimet që kanë të bëjnë me dialogun Kosovë - Serbi. "Siç parashihet me dispozita kushtetuese, ekzekutivi (kryeministri në koordinim me presidentin) udhëheq politikën e jashtme, në këtë rast edhe dialogun me Serbinë, ndërsa Kuvendi është organi më i lartë mbikëqyrës i këtij procesi. Përfaqësuesit ekzekutivë e kanë obligim kushtetues që të raportojnë para Kuvendit lidhur me këtë çështje", ka deklaruar ajo, duke përmendur mekanizmat e tjerë parlamentarë që kanë deputetët për ta kontrolluar kryeministrin. "Deputetët kanë në dispozicion mekanizma të ndryshëm të mbikëqyrjes siç janë pyetjet parlamentare, debatet, interpelancat, rezolutat dhe thirrjet në raportim. Përveç raportimeve në seanca, deputetët kanë mundësi që t'i thërrasin përfaqësuesit ekzekutivë edhe për raportime në komisione parlamentare për tema të caktuara të dialogut dhe marrëveshjes së arritur, sipas fushëveprimit të komisioneve", ka thënë ajo.

Më herët, deputetja e PDK-së, Ariana Musliu-Shoshi, ka kërkuar që deputetët duhet të informohen paraprakisht për takimet e Brukselit dhe takimet e tjera që kanë të bëjnë me bisedimet Kosovës - Serbi. Ajo pati deklaruar për "Epokën e re" se për takimin e Uashingtonit deputetët anëtarë të Komisionit Parlamentar për Politikë të Jashtme nuk e kanë pasur asnjë informacion zyrtar. "Si Komision për Punë të Jashtme ne i kemi mbajtur disa mbledhje, por në të cilat nuk kemi marrë as informacione sipërfaqësore për procesin e dialogut. Kurse sa i përket takimit të 4 shtatorit, ne nuk e kemi asnjë informatë zyrtare, përveç atyre që janë thënë në portale dhe studio televizive. Kjo tregon joseriozitetin e kryeministrit si udhëheqës i këtij procesi", ka deklaruar Musliu-Shoshi.

# Presidenti Thaçi pranoi letrat kredenciale nga ambasadori i ri hungarez Jozsef Bencze

**Presidenti Thaçi ka shprehur vullnetin e Kosovës për më shumë bashkëpunim në fusha të interesit të përbashkët, e sidomos në aspektin e rimëkëmbjes së ekonomisë nga pandemia e shkaktuar nga virusi Covid-19**



PRISHTINË, 15 SHTATOR (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka pranuar të martën letrat kredenciale nga ambasadori i ri i Hungarisë, Jozsef Bencze. Duke i uruar ambasadorit mirëseardhje në Kosovë, presidenti Thaçi ka theksuar se marrëdhëniet e mira diplomatike ndërmjet Kosovës dhe Hungarisë duhet të shtrihen edhe më shumë në fushën e ekonomisë, arsimit dhe kulturës. "Jemi mirënjohës për mbështetjen që Hungaria i ka dhënë shtetit të Kosovës në vazhdimësi. Presim të thellojmë këtë bashkëpunim në të gjitha fushat", ka thënë presidenti Thaçi.

Presidenti Thaçi ka shprehur vullnetin e Kosovës për më shumë bashkëpunim në fusha të interesit të përbashkët, e sidomos në aspektin e rimëkëmbjes së ekonomisë nga pandemia e shkaktuar nga virusi Covid-19.

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi ka pranuar letrat kredenciale edhe nga ambasadorja e re e Mbretërisë së Holandës, Carin Lobbezoo.

Kreu i shtetit i ka uruar mirëseardhje në Kosovë ambasadores Lobbezzoo, derisa ka theksuar se Holanda është partnere e rëndësishme për Kosovën, në veçanti sa i përket integrimit të Kosovës në BE dhe liberalizimit të vizave, ku vendi ynë ka nevojë për mbështetje të fuqishme nga aleatët evropianë. "Kosova do të vazhdojë të punojë me përkushtim në agjendën evropiane", ka thënë Thaçi.

# I jepet lamtumira e fundit aktorit Adem Mikullovci




**Të martën në varrezat e qytetit në Dragodan (Arbëri) i është dhënë lamtumira e fundit aktorit dhe politikanit Adem Mikullovci. Në ceremoninë mortore morën pjesë familjarë, përfaqësues të komunitetit artistik dhe përfaqësues të institucioneve të vendit. Bashkëshortja e tij, Lumnije Mikullovci, tha se Ademi ka jetuar me teatër dhe film. Ndërkaq përfaqësues të institucioneve dhe përfaqësues të komunitetit artistik kanë vlerësuar se Adem Mikullovci do të jetë i paharruar në mesin tonë me shpirtin e madh fisnik dhe artistik dhe me trashëgiminë e pashterur artistike që ka lënë pas**

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 15 SHTATOR - Në prani të familjarëve, komunitetit të artistëve, përfaqësuesve të institucioneve të vendit dhe qytetarëve të pranishëm, të martën në varrezat e qytetit në Dragodan (Arbëri) i është dhënë lamtumira e fundit aktorit dhe politikanit Adem Mikullovci, i cili ndërroi jetë në moshën 81-vjeçare. Përgjatë jetës së tij ai ka luajtur në shumë projekte filmike, teatër, komedi dhe shumë performanca të tjera artistike. Ai ka qenë delegat i Kuvendit i cili shpalli Deklaratën Kushtetuese dhe të Pavarësisë nga viti 1990-1992, si dhe u zgjodh deputet i Kuvendit të Kosovës në legjislaturën e kaluar. Bashkëshortja e tij, Lumnije Mikullovci, ka thënë se Ademi ka jetuar me teatër dhe film. Ajo ka treguar momentet e fundit të jetës së bashkëshortit të saj. "Ka qenë sëmurë vitin e kaluar, por këtë vit ka qenë shumë mirë. Fjalët e fundit ai nuk pati kohë t'i thotë, sepse aorta abdominale e bëri të veten dhe kanë qenë dy minuta në pyetje. Por, para asaj ai e luajti një shfaqje të tekstit të tij për film. E luajti para meje, fqinjës sime, aq me emocione sa kur u krye, i thashë: 'Adem, ti e luajte një shfaqje, na dhe një përjetim shumë emocional'. Aktori e ndien se i ka ardhur momenti. Ai ka jetuar me teatër dhe me film. Aq ishte jeta e tij", ka thënë Lumnije Mikullovci.

Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, i ka shprehur ngushëllime familjes Mikullovci, duke theksuar se Adem Mikullovci do të jetë përherë në kujtimet tona me veprën e tij të pamohueshme e të pashlyeshme që ka lënë pas. "E nderuar familja Mikullovci, me pikëllim dhe me mërzi të madhe e mora lajmin për ndarjen nga jeta e të dashurit tuaj, krenarisë tonë artistike, aktorit, skenaristit e regjisorit tonë të madh, bacës Adem. Baca Adem më nuk do të jetë i pranishëm me trupin e tij, por do të jetë i paharruar në mesin tonë me shpirtin e tij të madh fisnik e artistik dhe me trashëgiminë e pashterur artistike që ka lënë pas. Ai do të jetë përherë në kujtimet tona me veprën e tij të pamohueshme e të pashlyeshme që ka lënë pas, si një rrugë të shtruar fort për brezat që vijnë. Numri i roleve dhe veprave artistike e të papërsëritshme të bacës Adem do të mbesin xhevahire të çmuara dhe do të jenë gjurmë të skalitura e të pashlyera në botën e artit e të aktrimit. Me praninë e tij, ai e ka pasuruar dhe e ka bërë madhështore çdo vepër artistike dhe i ka dhënë peshë roleve që i ka marrë mbi supe t'u japë shpirt", ka thënë Dumoshi.

Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka thënë se Adem Mikullovci edhe si aktor, edhe si delegat që votoi Deklaratën Kushtetuese më 2 korrik dhe Kushtetutën e Kaçanikut më 7 shtator 1990, por edhe si deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, ai gjithnjë ishte në shërbim të interesit publik dhe vendit tonë. "Kontributi i tij në art, kulturë dhe politikë do të kujtohet përgjithmonë. Ngushëllime familjes Mikullovci dhe të gjithë artdashësve, miqve dhe të afërmve të tij", ka thënë Thaçi.

Kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, ka theksuar se skena teatrore humbi njeriun e madh, i cili jetën e tij prej aktori nuk e ndante nga angazhimi qytetar, duke qenë delegat i përbërjes së Deklaratës së 2 Korrikut dhe Kushtetutës së Kaçanikut për ta përmbyllur angazhimin e tij politik në mandatin e kaluar si deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës. "Sot vendi mbeti pa aktorin e politikanin e shquar, mbeti pa një zë kritik, i cili iku me dëshirën për një Kosovë më të mirë", është shprehur Osmani.

Kryeministri Avdullah Hoti, i shoqëruar nga zëvendëskryeministrat Besnik Tahiri dhe Driton Selmanaj dhe bashkëpunëtorët, ka bërë homazhe dhe ka vendosur kurora me lule para Teatrit Kombëtar të Kosovës në Prishtinë, për ish-deputetin dhe aktorin Adem Mikullovci, me rastin e ndarjes nga jeta. "Sot po nderojmë një figurë që mbetet ikonë e artit në Kosovë, e teatrit dhe televizionit, jo vetëm për një gjeneratë, po për shumë gjenerata në Kosovë. Besoj se vepra e tij artistike do të mbetet në arkiva dhe do të mbetet vepër dhe trashëgimi e shtetit të Kosovës. Përtej kësaj, Adem Mikullovci ka luajtur rol kyç në faza të caktuara të artikulimit të idesë së shtetit të Kosovës, të aspiratave të qytetarëve të Kosovës për liri, pavarësi dhe për shtet. Do ta kujtoj me mall edhe për bisedat shumë të këndshme që kam pasur me të gjatë kohës sa ishim në Kuvend, në legjislaturën paraprake. U shpreh ngushëllime familjes së tij, miqve dhe gjithë komunitetit artistik dhe qytetarëve për ndarjen të këtij artisti të madh", ka thënë kryeministri Hoti.

Ngushëllime familjes Mikullovci i kanë shprehur edhe komuniteti artistik, përfaqësues të shoqërisë civile, kryetari i LV-së, Albin Kurti, ai i AAK-së, Ramush Haradinaj, lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj dhe kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti.

# MKRS-ja dhe UP-ja nënshkruajnë memorandum për bursa studimi për trashëgiminë kulturore



EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 15 SHTATOR - Studentët e Universitetit të Prishtinës nga e marta do ta kenë mundësinë e përkrahjes për specializim në fushën e trashëgimisë kulturore. Për këtë punë u nënshkrua memorandum bashkëpunimi në mes të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", i cili ua mundëson studentëve të UP-së sigurimin e bursave me qëllim të aftësimit dhe avancimit në programet e specializuara për trashëgimi kulturore.

Memorandumi u nënshkrua me qëllim të zbatimit të programit për ofrimin e bursave për studime nga studentët që janë shtetas të Republikës së Kosovës, përkatësisht studentë të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në universitetet e Bashkimit Evropian dhe më gjerë.

Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi dhe rektori Marjan Dema, nënshkruan memorandumin bashkëpunimit i cili konkretisht parasheh bursa për studentët e shkencave arkeologjike deri në katër bursa: antropologji fizike dhe/apo biologjike deri në dy bursa; antropologji kulturore apo/dhe linguistike një bursë; arkeologji klasike ose Histori e Artit-deri në një bursë; arkitekturë/konservim restaurim deri në një burse.

Procesi i aplikimit dhe pranimit do të zhvillohet në dy faza, atë të selektimit të kandidatëve dhe fazën e intervistave.

Ministrja Dumoshi në fjalën e saj u shpreh se është një nder të jetë e pranishme në Rektorat për ta kryer ceremoninë e nënshkrimit të këtij memorandumi dhe tha se kjo është marrëveshja e tretë që MKRS-ja nënshkruan me UP-në. "Sot është 15 shtatori dhe tani fillon Muaji i Trashëgimisë dhe mesazhi i këtij muaji është 'Trashëgimia dhe edukimi', andaj MKRS-ja sot e nënshkruan një marrëveshje e cila është domethënëse për ekspertët e gjeneratave të reja të fushave të cilat janë shumë të ndjeshme si arkitektura, arkeologjia dhe antropologjia. Ne jemi të gatshëm që studentët më të mirë që do t'i përzgjedhë UP-ja që t'i përkrahim që ata të studiojnë dhe ta marrin ekspertizën në universitetet më të mira të BE-së dhe më pas ata të kthehen dhe të punojnë në vendin tonë", ka thënë ministrja Dumoshi.

Ajo ka theksuar se Kosova i ka institucionet e veta që janë nën ombrellën e MKRS-së. "Ne kemi nevojë për ngritjen e kapaciteteve njerëzore andaj këto marrëveshje kanë një domethënie dhe më këtë rast i ftoj të gjithë studentët t'i shohin këto fusha të rëndësishme ku hulumtohet e studiohet trashëgimia kulturore e Kosovës. Ne me shumë përkushtim e kemi ndarë buxhetin dhe do t'i financojmë këta studentë", është shprehur Dumoshi.

Ndërkaq, Rektori i Universiteti të Prishtinës, Marjan Dema, ka theksuar se është në përfundim të mandatit të tij dhe nënshkrimi i kësaj marrëveshje në përfundim të detyrës ka një domethënie të madhe pasi që MKRS-ja i ka kushtuar një rëndësi të madhe Universitetit "Hasan Prishtina", ku studiojnë 42 mijë studentë. "Investimi më i mirë në ndryshime pozitive është investimi në universitet, ku me anë të kësaj marrëveshje do të përfitojnë shumë studiues e hulumtues, shumë studentë dhe ky do të jetë një stimulim dhe do të jetë një entuziazëm më i madh për të studiuar e hulumtuar në tri fusha që, fatkeqësisht, nuk janë prekur përpara, në arkitekturë, antropologji dhe arkeologji. Dhe sigurisht se ato bursa që do të ndahen do të japin një mundësi më të madhe që të kemi ekspertë në këto fusha", ka deklaruar rektori Dema, i cili edhe ka shprehur mirënjohjen për ministren dhe MKRS-në që UP-së i kanë kushtuar një kujdes të veçantë.

# Kryeministri nderon policët që kanë pësuar në krye të detyrës





PRISHTINË, 15 SHTATOR (ER) - Kryeministri Avdullah Hoti, i shoqëruar nga zëvendëskryeministri Driton Selmanaj, ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliu dhe drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ka pritur të martën në takim policët e plagosur në krye të detyrës, Artur Mrasori dhe Jetmir Hasanaj, të kthyer nga trajtimi mjekësor jashtë vendit. "Sot po takojmë dy policët që janë lënduar, kanë pësuar në krye të detyrës dhe përmes këtij takimi të dy policëve, takojmë simbolikisht të gjithë ata policë që janë lënduar në krye të detyrës, si shenjë respekti që shteti i Kosovës ka për ata që janë duke kryer detyrën shtetërore për sigurinë e qytetarëve, për sigurinë publike, që rrezikojnë jetën dhe shëndetin e tyre", ka thënë Hoti, duke shtuar se ky takim është realizuar për t'u treguar se do t'u qëndrojnë gjithmonë afër, me mundësitë që i ka shteti i Kosovës. "Biseduam edhe me ministrin që do të kujdesemi që në mënyrë institucionale t'i rregullojmë njëherë e përgjithmonë këto çështje përmes Ligjit për sigurimin e jetës dhe shëndetit të policëve dhe Ligjit për pensionim të parakohshëm, në mënyrë që policët që lëndohen, që bien në krye të detyrës, familjet e tyre, të mos ndihen të ngarkuara, por atë barrë ta marrë shteti. Këta janë heronjtë e kohës moderne, sepse çdo ditë që dalin në rrugë e rrezikojnë jetën e tyre duke tentuar ta ruajnë jetën e zyrtarit shtetëror, sigurinë e institucioneve ose sigurinë e qytetarëve në përgjithësi", ka deklaruar kryeministri Hoti.

Më tej, kryeministri Hoti teksa vlerësoi punën e zyrtarëve policorë tha se çdo ditë që dalin në mëngjes, ata përshëndeten me familjen duke mos ditur se si do të kthehen në mbrëmje dhe kjo tregon një përkushtim të lartë që kanë këta zyrtarë shtetërorë në punën e tyre të përditshme.

Vështrim i Institutit Demokratik i Kosovës (KDI) për Ditën Ndërkombëtare të Demokracisë

# Demokracia në kohë pandemie




Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Demokracisë, ditë e cila na ofron mundësi të gjithëve për të reflektuar mbi gjendjen e demokracisë në vendin tonë e gjithandej në botë. Vlerat e lirisë, respektimi i të drejtave të njeriut dhe mbajtja e zgjedhjeve të rregullta e të lira duke garantuar të drejtën universale për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur janë elemente thelbësore të demokracisë.

Që nga shënimi i kësaj dite në vitin e kaluar, Kosova ka përmbyllur një cikël zgjedhor që, sipas raporteve vendore e ndërkombëtare, kishte përmbushur standardet më të larta demokratike, Sidoqoftë, mungesa e konsensusit të brendshëm rreth çështjeve madhore dhe krizat e njëpasnjëshme politike që rrodhën si pasojë e kësaj kanë rezultuar me ndërrimin e qeverive brenda një periudhe të shkurtër kohore. Kjo ka pamundësuar reformat në konsolidimin e demokracisë, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, forcimin e shtetit të së drejtës dhe sundimit të ligjit si dhe përmirësimin e imazhit të shtetit të Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Rrëzimi i qeverisë në periudhën e pandemisë dhe procedurat e gjata kushtetuese për formimin e qeverisë së re e kishin lënë vendin pa institucione ekzekutive me funksion të plotë në periudhën kur qytetarët kishin më së shumti nevojë për to. Në anën tjetër, Kuvendi nuk arrinte të ushtronte funksionin e tij mbikëqyrës ndaj ekzekutivit në kohën kur (sikurse edhe në mbarë botën) procesi i vendimmarrjes ishte përshpejtuar dhe shpeshherë nuk kishte kohë për konsultime paraprake me publikun dhe kur alokoheshin mjete të shumta buxhetore me procedura emergjente. Në anën tjetër, në mungesë të konsensusit politik Kuvendi nuk arriti të adaptojë Rregulloren e Punës për t'u përshtatur me situatën e krijuar me pandeminë dhe për pasojë në disa raste u detyrua të reduktojë përkohësisht punën, edhe për shkak të përhapjes së virusit brenda Kuvendit. Me një dinamikë të plogësht të punës në kohë pandemie dhe mungesë të theksuar të konsensusit politik, Kuvendi nuk arriti t'i përmbushë përgjegjësitë e tij kushtetuese në raport me procesin ligjvënës, mbikëqyrës ndaj pushtetit ekzekutiv, si dhe të përfaqësimit të interesave të qytetarëve.

Dialogu Kosovë-Serbi si një ndër proceset më të rëndësishme politike ka vazhduar të prodhojë polarizim të tejskajshëm politik duke u bërë shpesh edhe faktor përcaktues i jetëgjatësisë së disa qeverive me radhë. Mungesa e kohezionit politik dhe atij shoqëror, në sferën e brendshme ndikoi në funksionimin demokratik të institucioneve dhe prodhimit të krizave të vazhdueshme politike. Ndërsa në planin e jashtëm, shpërfaqi politikë të pakoordinuar dhe të paunifikuar shtetërore. Politikat e ngushta partiake jo rrallë herë mbizotëruan diskurset politike ndërsa mungesa e gatishmërisë për të ndërtuar një konsensus të gjerë politik rreth kësaj çështjeje mbetet një sfidë e procesit. Kjo e fundit është vënë re dhe në dinamikat në mes të partive politike pjesë të koalicionit qeverisës të cilat shpesh herë kanë shpërfaqur qëndrime të ndryshme lidhur me procesin e dialogut. Si dhe në kundërshtimet dhe hezitimin e vazhdueshëm të partive opozitare për tu bërë pjesë qoftë të delegacioneve apo dhe për të pasur takime të përbashkëta informuese apo/dhe koordinuese.

Në anën tjetër, mungesa e transparencës në njërën anë dhe e qartësisë rreth procesit të ndërmjetësuar nga BE, atij nga SHBA-të dhe vetë statusi i marrëveshjeve tashmë të arritura në mes palëve, krijuan konfuzion dhe paqartësi tek qytetarët. Natyra e mbyllur e këtyre diskutimeve, shpërfaqi mungesën e vullnetit, llogaridhënies dhe dobësive që Kuvendi i ka në raport me ushtrimin e një mbikëqyrje efikase.

Sundimi i ligjit - Ndërhyrjet politike vazhdojnë të cenojnë sistemin e drejtësisë në vend e më këtë edhe vet demokracinë. Shkelja e të drejtave të njeriut shpeshherë burimin e ka në vet sektorin e drejtësisë. Gjykime të papërfunduara në kohë, aktakuza pa prova të mjaftueshme dhe parashkrime në shumë lëndë janë vetëm disa nga format e shkeljes së të drejtave të njeriut. Gjendja rreth trajtimit të lëndëve është rënduar edhe më shumë gjatë pandemisë, për shkak të punës me kapacitete të kufizuara të organeve të drejtësisë.

Mungesa e rezultateve në luftën kundër korrupsionit ka bërë që Kosova të vazhdojë të shënoi rënie në Indeksin Vjetor të Perceptimit të Korrupsionit (CPI). Me 36 pikë, Kosova sivjet kishte humbur edhe një pikë në sistemin e vlerësimit (nga 37 sa kishte më 2018) dhe kishte pësuar rënie nga pozita e 93-të në atë të 101-të. Përkundër faktit se përpjekjet e Qeverisë Kurti për të pastruar bordet e ndërmarrjeve publike nga militantë partiakë dukeshin premtuese, emërimi i anëtarëve të rinj nga partitë e koalicionit qeverisës LV - LDK në po ato borde pothuajse kthen gjendjen në nivelin e njëjtë.

Kosova si demokracia më e re në Evropë do të mund të krenohej me nivelin e demokracisë së saj nëse institucionet dhe qytetarët mbesin të vendosur për të kultivuar dhe mbrojtur vlerat e demokratike, ku mirëqenia e qytetarëve garantohet nga një sistem politik që mundëson ambient për një garë zgjedhore të mirëfilltë dhe transparente, ku fitojnë idetë dhe kandidatët më të mirë, ku lufta kundër korrupsionit dhe sundimi i ligjit është i pakompromis dhe ku qytetarët rrisin kërkesat për llogaridhënie dhe pronësinë në vendimmarrje.

# Zemaj premton një autoambulancë dhe pajisje të tjera për QKMF-në në Skenderaj



**Prishtinë, 15 shtator (ER)** - Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka pritur të martën në takim kryetarin e Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, me të cilin ka biseduar për situatën rreth pandemisë Covid-19 dhe për përpjekjet e përbashkëta për ta parandaluar përhapjen e këtij virusi.

Zemaj ka thënë se pushteti lokal ka rol të rëndësishëm për tejkalimin e gjendjes së krijuar nga virusi. "Andaj bashkë me kryetarin Jashari do të punojmë për të mirën e qytetarëve dhe për ruajtjen e shëndetit publik. Si ministër i Shëndetësisë, duke ofruar ndihmë logjistike për shëndetësinë e kësaj komune, konfirmova se Skenderaj do të vazhdojë ta ketë përkrahjen time dhe mbështetjen në projektet e caktuara. Tashmë Skenderaj është i përfshirë në dy projekte konkrete, në konkursin e fundit për shkollim specialistik ku, sipas kërkesave, iu kemi dhënë hapësirë disa kandidatëve që do t'i ndjekin specializimet për Mjekësi familjare, Gjinekologji dhe Obstetrikë, Pediatri dhe do t'u shërbejnë qytetarëve të Skenderajt si dhe në konkursin nga Granti i Bankës Botërore 'Projekti i Shëndetësisë Kosovare' për rekrutimin e 375 profesionistëve do të angazhohen edhe profesionistë të tjerë nga kjo komunë", ka thënë ministri Zemaj.

Ai ka shtuar se në ditët në vazhdim QKMF-së në Skenderaj do t'i dhurohet një autoambulancë dhe pajisje të tjera. "Deri më tani nuk kanë munguar edhe ndihmat që janë dhënë nga donacionet e ndryshme që kanë ardhur në Kosovë nga shtetet mike në adresën e Ministrisë së Shëndetësisë. E falënderova kryetarin Jashari për gatishmërinë për ta vazhduar bashkëpunimin e shkëlqyeshëm", ka thënë Zemaj pas takimit.

# Abrashi: Projektet me vendet e Ballkanit Perëndimor lehtësojnë lëvizjen e njerëzve dhe mallrave



PRISHTINË, 15 SHTATOR (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi, pas takimit me Matej Zakonjshek, sekretar i përhershëm i Komunitetit të Transportit në Komisionin Evropian, ka thënë se kanë diskutuar për projektet e përbashkëta të vendeve të Ballkanit Perëndimor që për synim kanë lehtësimin e lëvizjes së njerëzve dhe mallrave.
Ministri Abrashi në një konferencë për media ka thënë se Kosova është gati për takimin e ministrave të Transportit që do të mbahet në Bruksel, që synohet financimi i projekteve për rajonin. "Kemi diskutuar çështje me rëndësi për vendin dhe për rolin e këtij komuniteti për Ballkanin Perëndimor. Ky komunitet tani ka katër prioritete të cilat ndërlidhen me lëvizjen e lirë të qytetarëve. E para ka të bëjë me përmirësimin e infrastrukturës hekurudhore dhe gjithçka që ndërlidhet me transportin hekurudhor, e dyta ka të bëjë me përmirësimin dhe ndihmën që i jep Ballkanit Perëndimor në infrastrukturën rrugore. E treta ka të bëjë me sigurinë në rrugë dhe në trafik dhe e katërta ka të bëjë me të gjitha lehtësirat në transportin rrugor, hekurudhor në mes vendeve të Ballkanit. Ne sot kemi diskutuar për shumë çështje që prekin edhe Kosovën edhe vendet e Ballkanit perëndimor dhe synojmë të bëjmë edhe një plan veprimi në fillim të muajt të ardhshëm i cili do t'i paraprijë takimit të ministrave të Transportit në Bruksel ku do të diskutojmë për të gjitha këto", ka thënë Abrashi.
Ndërsa Matej Zakonjshek ka theksuar se kanë një plan të qartë për ta ndihmuar Ballkanin në modernizimin e transportit me qëllim zhvillimin ekonomik.

# ASK-ja: Ka rritje të tregtisë me pakicë



PRISHTINË, 15 SHTATOR (ER) - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar "Statistikat Afatshkurtra të Tregtisë me Pakicë" për tremujorin e dytë (TM2) 2020. Përmes këtij publikimi janë prezantuar të dhënat për qarkullimin dhe numrin e të punësuarve. Sipas ASK-së, në tremujorin e dytë të vitit 2020, krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2020, ka pasur rritje te: Tregtia me pakicë e pajisjeve informatike dhe të komunikimit, në dyqane të specializuara (32.6 për qind); Tregtia me pakicë e pajisjeve të tjera shtëpiake, në dyqane të specializuara (14.6 për qind); dhe Tregtia me pakicë jo në dyqane, tezga ose tregje (10.6 për qind). "Derisa, gjatë këtij tremujori, kanë shënua rënie: Tregtia me pakicë e karburantit për automjete, në dyqane të specializuara (9.1 për qind); Tregtia me pakicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, në dyqane të specializuara (7.1 për qind); Tregtia me pakicë e mallrave të tjera, në dyqane të specializuara (6.5 për qind); Tregtia me pakicë e mallrave kulturore dhe të argëtimit, në dyqane të specializuara (4.7 për qind); dhe Tregtia me pakicë e mallrave të tjera, në dyqane jo të specializuara (0.7 për qind")", thuhet në raportin e ASK-së.

# Prodhuesit e qumështit takohen me kryeministrin, kërkojnë përkrahje nga qeveria



PRISHTINË, 15 SHTATOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, i shoqëruar nga ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Besian Mustafa dhe ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, kanë pritur në takim prodhuesit e qumështit, me të cilët ka diskutuar për sfidat me të cilat po përballet ky sektor gjatë kohës së pandemisë si dhe për mundësinë që Qeveria e Kosovës t'u dalë në ndihmë. Me këtë rast, përfaqësuesit e prodhuesve të qumështit e njoftuan kryeministrin Hoti për sfidat me të cilat është duke u ballafaquar ky zinxhir prodhues si pasojë e pandemisë Covid-19 për prodhimet e tyre që po mbesin pa u plasuar në treg, në të njëjtën kohë kërkuan mbështetjen e kryeministrit Hoti dhe të Qeverisë së Kosovës për tejkalimin e kësaj situate.
Kryeministri Hoti ka thënë se qeveria është e gatshme për ta ndihmuar këtë sektor brenda mundësive ligjore dhe financiare. "Qeveria e Kosovës është duke punuar me përkushtim për mbështetjen e sektorit privat dhe të prodhuesve vendës dhe përmes ministrive të linjës do të gjenden mënyra të përshtatshme për përballimin dhe tejkalimin e sfidave, me të cilat po përballen prodhuesit tanë, duke përfshirë edhe prodhuesit e qumështit", ka theksuar kryeministri Hoti, i cili ka kërkuar që Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë ta shtojë kontrollin në terren për të siguruar ndarje të qartë të produkteve me bazë qumështin e freskët.

# Krasniqi: Shqetësimet e bizneseve janë adresuar në kuadër të pakos për rimëkëmbje ekonomike



PRISHTINË, 15 SHTATOR (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, ka pritur të martën në takim drejtuesit e Odës së Afaristëve të Kosovës. Ai ka bërë me dije se në këtë takim është biseduar për problemet e bizneseve në kohë pandemie, pakon e Qeverisë së Kosovës për rimëkëmbje ekonomike, problemet me Serbinë gjatë transportimit të mallrave si dhe vendimin për ndalimin e vajit të palmës. "I njoftova që shumë prej kërkesave të tyre kanë hyrë në kuadër të paketës për rimëkëmbje ekonomike e cila shumë shpejt do të nisë së zbatuari", ka thënë Krasniqi.

# Meremetimi i qendrës shëndetësore në Tërpezë, drejt përfundimit

MALISHEVË, 15 SHTATOR (ER) - Në kuadër të investimeve në sektorin e shëndetësisë është duke u investuar edhe në meremetimin e objekteve ekzistuese, të cilat janë dëmtuar për shkak të kohës apo faktorëve të tjerë, kanë filluar punimet në meremetimin e tërësishëm të objektit të qendrës shëndetësore në fshatin Tërpezë të Komunës së Malishevës.

Punimet në meremetimin e kësaj qendre shëndetësore të martën i kanë parë nga afër i pari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, drejtori për Shëndetësi Liridon Hoti dhe ai i Gjeodezisë dhe Kadastrës, Bashkim Krasniqi, të cilët janë njoftuar me ecurinë e punimeve. "Jemi përkushtuar që të investojmë në sektorin e shëndetësisë, me qëllimin e vetëm që të ofrojmë shërbime sa më të mira shëndetësore dhe kushte më të mira për punë për punëtorët shëndetësorë, prandaj jemi duke investuar edhe në meremetimin e objekteve", ka thënë kryetari Begaj, gjatë vizitës në Tërpezë.

Drejtori për Shëndetësi, Liridon Hoti, ka sqaruar se këto investime janë në kuadër të planifikimeve për investime në sektorin e shëndetësisë dhe



meremetimi i tërësishëm i objektit të kësaj qendre shëndetësore, mundësohet nga buxheti i Komunës së Malishevës. Ai ka thënë se punimet janë duke shkuar sipas planit dhe së shpejti kjo qendër do të rifillojë me ofrimin e shërbimeve shëndetësore.

## Së shpejti funksionalizohet Spitali i Podujevës



PODUJEVË, 15 SHTATOR (ER) - Së shpejti pritet të funksionalizohet Spitali i Përgjithshëm në Podujevë. Ushtruesi i detyrës i drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, Valbon Krasniqi, ka autorizuar Afrim Tahiri, kirurg i përgjithshëm, përgjegjës për funksionalizim të Spitalit të Podujevës. Ai ka për detyrë ta bëjë planifikimin e kuadrit profesional, teknik-administrativ dhe pajisjeve mjekësore. Po ashtu, koordinimin, bashkërendimin, monitorimin dhe raportimin e zbatimit të aktiviteteve dhe veprimeve lidhur me funksionalizimin e Spitalit të Përgjithshëm në Podujevë. Vendimi për themelimin e Spitalit të Përgjithshëm në Podujevë ishte marrë në vitin 2016 nga ministri i atëhershëm i Shëndetësisë, por nuk ishte funksionalizuar deri tani.

## Ndahen 100 mijë euro për Parkun e Dëshmorëve në Suharekë

SUHAREKË, 15 SHTATOR (ER) - Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, së bashku me kryetarin e Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, kanë nënshkruar të martën memorandumin e bashkëpunimit për bashkëfinancim në Parkun e Dëshmorëve në Suharekë. Ai ka thënë se kontributi me jetë për ta çliruar Kosovën bën që edhe vendi ku prehen dëshmorët të jetë i rregulluar dinjitetshëm dhe bukur. "Kështu do të jetë në Suharekë. Komuna tashmë ka kryer punë në atë park dhe ende do të investojë, teksa Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit do ta ndihmojë me 100 mijë euro", ka thënë ministri Kuçi.



# Për vitin e ri shkollor, rinovohet edhe një shkollë në Lipjan

LIPJAN, 15 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, i shoqëruar edhe nga bashkëpunëtorët, ka vizituar Shkollën e Mesme Profesionale "Adem Gllavica" në Lipjan, e cila është rinovuar në tërësi me financim nga Departamenti i Ushtrisë Amerikane në Evropë.

Kryetari Imri Ahmeti ka falënderuar donatorët për këtë investim shumë të nevojshëm, po ashtu ka uruar nxënësit dhe personelin arsimor për fillimin e vitit të ri shkollor, duke iu dëshiruar shëndet në këto rrethana jo të zakonshme të përballjes me pandeminë Covid-19.

Ahmeti ka kërkuar nga nxënësit kujdes më të shtuar për ruajtjen e këtyre hapësirave moderne. Rinovimi i tërësishëm i ShMP "Adem Gllavica", ka kushtuar rreth një milion euro dhe është investimi më i madh për renovimin e shkollave në regjion.





# Sabit Brokaj, një jetë e tërë në shërbim të kombit dhe atdheut, deri në përjetësi!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

**Lufta si mjet për arritje të paqes:** Baca Adem jetësisht ishte i interesuar që çështja e Kosovës mundësisht të zgjidhej në mënyrë paqësore ose, si alternativë, me sa më pak viktima ndonëse, me kalimin e kohës dhe duke e njohur politikën gjenocidale të Serbisë, edhe karakterin puro kriminal të Sllobodan Milloshevigit, ishte i sigurt se nuk do të kalojmë me pak viktime. Realisht, në të gjitha takimet me shokë, kundërshtarë politikë dhe debatet në mediat e Serbisë, Baca Adem thoshte se: "Vetëm liria nuk ka çmim dhe për ta fituar lirinë ka kuptim dhe është e domosdoshme të flijohet edhe jeta..." Në këtë kontekst, duke ditur se lufta me Serbinë është e pashmangshme, kërkonte përkrahje politike dhe ushtarake kudo që besonte se do të përkrahej. Tërë kohën, së bashku me Ahmet Haxhiun punonin për të krijuar kushte që të mos ziheshin në befasi aq më parë që dhuna kishte eskaluar, deri në gjenocid në hapësirat e ish Jugosllavisë. Edhe Shashivar Makolli - Qali ka qenë kumbar kudo që është folur për lirinë dhe kudo që ishte shkrepur një plumb për liri, në të gjitha trojet ku jetonin shqiptarët e që ishin të robëruar. Që nga dalja e fundit nga burgu (1990) para fillimit të luftës, në prag dhe në fillim të luftës logjistikën e Bacës Adem, veturën dhe të gjitha shpenzimet i hiqnin Nuhi Ahmeti - Llapqini dhe Avdullah Dërgutu - Dula Taraku. Nuhiut nofkën ia kishte lënë Baca Adem kurse Avdullahut, për shkaqe objektive ia pata lënë unë. Dua të theksoj se Llapqini dhe Dul Taraku kanë ndihmuar shumicën e atyre që ishin rrezikuar duke i dërguar jashtë Kosovës sikur që edhe Elmi Reçicën, kur e ndante vetëm një fije peri nga arrestimi e dërguan në Zonën e Çyqavicës për të vazhduar pastaj për në Zonën e Nerodimës. Baca Adem, nuk ndalej as ditën e as natën dhe gjithnjë ishte në lëvizje. Pas masakrës në Lagjen e Monollëve në Pollatë të Besianës, duke u kthyer rrugës Baca Adem më tha ta ndaloi veturën dhe, sa i mllefosur por edhe më shumë i vendosur tha se lufta paqësore më nuk ka kuptim dhe duhet të bëhemi gati me të gjitha mjetet dhe mundësitë për një luftë të armatosur ndërsa KMDLNj do ta kemi si bazë logjistike për sigurimin dhe shpërndarjen e informatave për dhunën e regjimit jugosllav dhe serb ndaj shqiptarëve. Këto fjalë i pati thënë vetëm edhe gjeneral Shaban Shalës në ndërkohë që pjesa dërrmuese e KMDLNj-së ishte në funksion të organizimit të luftës çlirimtare. Në KMDLNj erdhi edhe Xhavit Haziri që Këshillin e kishte vetëm si mbulesë në ndërkohë që ishte në vet majat e hierarkisë së UÇK-së. Elmi Reçica ishte pjesë e stafit dhe tërë kohën kalonte në terren. Në KMDLNj ishte edhe dr. Hafir Shala dhe Shaban Shala kështu që me Nuhiun, Avdullahun, Limkën, Binakun u bë një bërthamë e besueshme që ndihmoi dhe ishte pjesë aktive e rezistencës së armatosur e që përfundoi me luftën çlirimtare. Ishte edhe Rexhep Bislimi dhe shumë të tjerë që u burgosën, vdiqën nën torturë apo ranë në fushën e nderit duke u bërë heronj të lirisë dhe përjetësisë sikur që ishte komandant Remzi Ademaj, komandant Petriti.

**Dy gjeneralët e luftës për liri dhe çlirim të Kosovës, Baca Adem Demaçi dhe Sabit Brokaj:** Baca Adem Demaçi, në kërkim të përkrahjes politike dhe ushtarake shpesh shkonte në Shqipëri apo mbante kontakt me persona përgjegjës për këtë përkrahje. Kam qenë në rrjedha për takime dhe kontakte të shumta që ka pasur me Sali Berishën, Fatos Nanon, Ramiz Alinë, Pandeli Majkon, Rexhep Mejdanin dhe personalitete të tjera politike dhe ushtarake të Shqipërisë. Ishte takuar edhe me Ahmet Krasniqin për të cilin kishte mendim shumë të mirë. Pas këtyre takimeve kishte ndjenja të përziera, herë ishte i ngazëllyer e herë ishte i dëshpëruar. Një lider i thoshte se do të përkrahim nëse na përkrahë kundër Ibrahim Rugovës. Tjetri thoshte se duhet ta masni shumë veten dhe të mos hyni në luftë me shpresë te ne sepse ne nuk jemi në gjendje ta mbrojmë as veten tonë. Një tjetër thoshte se ju përkrahi 100 për qind me një kusht që të mos më përmendni apo, asgjë nuk keni parë dhe asgjë nuk keni ndjerë nga goja ime. Ishte jashtëzakonisht i zemëruar dhe i mërzitur kur një personalitet nga vet majat e politikës shqiptare ishte treguar shumë shpërfillës ndaj kërkesës së Bacës Adem për sigurim të armatimit. Pas të gjitha argumenteve që ia tha Baca Adem, në një situatë të tensionuar iu drejtua me fjalët: "ndihmonani sepse në mungesë të armatimit njerëzit po vdesin dhe se as Shqipëria, nëse Kosova nuk çlirohet nuk do t'i mbijetoi agresionit të Serbisë dhe se, për me qenë më konkret, Kosova po digjet, Kosovës i është vënë flaka dhe zjarri nga Serbia..." Përgjigja e këtij të pafytyrit ishte: "le të digjet në flakë sepse nuk e nënshkruaj t'ua japim as edhe një armë të lehtë..." Në këto çaste të hidhërimit dhe zhgënjimit Bacës Adem iu afrua një person që nuk e njihja duke i thënë: "Baca Adem, jam Sabit Brokaj, ministër i Mbrojtjes dhe do ju përkrahim deri në çastin kur, nëse është nevoja tërë armatimin dhe potencialin ushtarak do ta vëmë në shërbim të luftës në Kosovë dhe vëllezërve tanë që po bëjnë një luftë heroike e cila, në të njëjtën kohë është edhe lufta jonë...". Baca Adem pastaj kishte edhe takime tjera me Sabit Brokajn të cilin e përshkruante si një patriot të paepur dhe i gatshëm për të gjitha sakrificat. Kardiolog me profesion, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, ministër i Shëndetësisë një kohë dhe në kohën më kritike për shqiptarët dhe Kosovën ishte Ministër i Mbrojtjes. Mjekët, sipas përkatësisë dhe natyrës duhet të jenë humanistë për aq kohë sa e bëjnë punën e mjekut por, nëse kemi parasysh përvojën e të gjitha luftërave, jashtë dhe brenda trojeve shqiptare e sidomos kohën kur janë angazhuar në mënyrë aktive në politikë, dëshmitë flasin se janë shndërruar, në shumë raste në kriminelë të luftës dhe kriminelë të politikës. Janë dehumanizuar duke ua shitur mendjen, shpirtin, trupin dhe kapacitetin profesional politikanëve injorantë që me çdo kusht e kanë gjakuar pushtetin dhe me çdo kusht kanë dashur ta mbajnë pushtetin. Sabit Brokaj ishte vlonjat, me tradita të larta njerëzore, morale, politike dhe mbi të gjitha kombëtare prandaj, në kohën e duhur dhe kur politika shqiptare nuk e çante fort kokën për luftën në Kosovë, mori përgjegjësi personale duke mos kursyer asgjë që i shkonte në ndihmë luftës në Kosovë. Baca Adem ka qenë i impresionuar me gatishmërinë e Sabit Brokajt për të ndihmuar luftën në Kosovë me të gjitha mjetet e disponueshme dhe, gjithmonë dhe në çdo rast për Sabit Brokajn ishte shprehur me respektin më të madh duke e konsideruar si një luftëtar dhe gjeneral të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Edhe Baca Adem, sikur edhe Sabit Brokaj, luftën e kishin vetëm pikënisje për liri dhe çlirim të Kosovës kurse bashkimin kombëtar e kishin si synim, me të cilin i zinte nata dhe agonte dita. Personalitetet e mëdha botërore, njerëzore, kombëtare, politike dhe morale dallohen nga vdekatarët e rëndomtë për faktin se në çastet e rëndësishme kur fasulja hahej kokërr për kokërr dhe kur vdekjen e kanë më afër se këmishën, interesin e përgjithshëm e kanë motiv dhe gatishmëri për çdo sakrificë ndërkaq që veten e tyre e shndërrojnë në një atom të interesit të përgjithshëm. Baca Adem Demaçi dhe Sabit Brokaj ishin njerëz të mëdhenj, shqiptarë edhe më të mëdhenj, humanistë që i tejkalojnë kufijtë lokalë dhe rajonalë dhe sakrifikues të pashembullt në mbrojtje të idealit të njerëzimit të jetojnë të lirë dhe sipas vullnetit të tyre. Një kohë kanë qenë të ndarë fizikisht por me një lidhje të përhershme shpirtërore në trajtën e luftës së pandërprerë për bashkim kombëtar që pjesërisht e arritën pas përfundimit të luftës në Kosovë duke e gatuar bukën dhe ëndrrën me shumë sakrifica, djersë dhe gjak. Po të ishte gjallë Baca Adem, shumë do të dëshpërohej dhe mërzitej për shkak të vdekjes së Sabit Brokajt.

Njerëzit e mëdhenj, njerëzit e mirë, atdhetarët e vërtetë, njerëzit me vlera të rralla dhe të vërteta, në një mjedis të ndryshkur që është në tokat ku mbijetojnë me shumë mund pjesa më e madhe e shqiptarëve, mund të ndjehen të lirë vetëm në botën e amshueshme kur kalojnë në përjetësi në ndërkohë që ndryshku njerëzor, kombëtar, politik dhe moral e duan përjetësinë e pushtetit të prekshëm ndërkaq që kanë frikë nga bota e amshueshme për faktin se pastaj askush nuk do t'i përmend më. Respekti që blihet me para dhe pushtet është rruga më e shkurtër dhe më e sigurt drejt harresës dhe, në jo pak raste mallkimit të historisë.

Prandaj, le t'i kujtojmë me respekt dy kolosët e çështjes kombëtare, Bacën Adem Demaçi që u bë i pavdekshëm në të gjitha hapësirat ku frymon njerëzimi dhe Sabit Brokaj, i amshueshëm në të gjitha hapësirat ku frymon shqiptaria!

E jashtëzakonshme

# Shteti që po i detyron të gropojnë varre ata që nuk i vënë maskat



Tetë njerëz që u kapën pa maska në regjencën e Gresikut të Indonezisë u obliguan të gërmojnë varre në një varrezë publike në fshatin Ngabetan, shkruajnë mediat britanike. “Momentalisht, në dispozicion për hapjen e varreve janë vetëm tre punëtorë, kështu që mendova t’i angazhoj këta njerëz”, ka thënë kreu i rrethit të Cerme, Syono.

## BARSOLETA E DITËS



**Mësuesja: Pse u vonove?**
**Nxënësi: Një burrë i kishte humbur 10 000 lekë.**
**Mësuesja: Ti me siguri e ndihmove t’i gjej.**
**Nxënësi: Jo mësuese, por i kisha shkelur me këmbë dhe ndenja derisa iku ai burri.**

KINO ABC PRISHTINE

**Në Kino ABC nuk ka shfaqje**





Australia 2000 $1/10c Mule Error Uncirculated PCGS UNC Details

| | | |
|---|---|---|
| Coin Type: | Australia 2000 $1/10c Mule | |
| Grade: | PCGS UNC Details | AUD$4,250 |
| Year: | 2000 | Add to cart |
| Mint: | Royal Australian Mint, Canberra | |
| Metal: | Aluminium Bronze | |
| Mass: | 9g | |
| Certificate Number: | 37040646 | |
| Obverse: | Elizabeth II (Ian Rank-Broadley) | |
| Reverse: | Mob of Roos (Stuart Devlin) | |

Australian Coin Collecting Blog

E rrallë

# Monedha 1 euro që kushton mijëra euro

Koleksionistët e monedhave po bëjnë oferta për një monedhë unike një eurosh të quajtur ‘mushkë’ përmes faqes së ankandit “The Purple Penny”, shkruajnë mediat e huaja. Monedhat janë më të dendura se një monedhë e rregullt një eurosh. Mushka po ofrohet për 4 250 dollarë dhe është përshkruar nga ankanderi si “më e bukura që kemi parë ndonjëherë”.

FOTO E DITES



Togu Ceremonial i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK)



**DASHI**
Në fushën profesionale yjet do t’ju premtojnë kënaqësi të madhe, gjithashtu ju kërkojnë një angazhim serioz.



**DEMI**
Mbani këmbët në tokë pasi vetëm kështu mund të shijoni atë që keni. Nga pikëpamja sentimentale, ju e dini mirë që, në fund të fundit, Hëna mundohet t’ju bëjë të ndiheni të qetë.



BINJAKËT
Projektet që nuk kanë ecuri dhe ngjarjet familjare ju shqetësojnë, por mos u shqetësoni nesër gjithçka, ose pothuajse gjithçka, do të zbutet.



GAFORRJA
Ditë e veçantë për lidhjen tuaj të dashurisë. Orët e kaluara me partnerin tuaj do të jenë gjithmonë ndër kujtimet më të mira.



**LUANI**
Një paqëndrueshmëri e lehtë emocionale e bën ditën tuaj gri. Mos e përbuz mbështetjen e një miku të besuar pasi vërtet do të kesh nevojë të flasësh, të besosh tek ai.



**VIRGJËRESHA**
E privilegjuar e madhe është zemra juaj, e hapur ndaj emocioneve të ëmbla dhe sugjerimeve të paharrueshme.



**PESHORJA**
Mendja e shëndoshë dhe korrektësia, në fakt, do të japin rezultatet e dëshiruara. Përkundër të papriturave dhe përgjegjësive të shumta familjare, ju keni një dëshirë të madhe për dashuri.



**AKREPI**
Filloni ditën me këmbën e majtë. Nevoja për ta frenuar padurimin mund t’ju bëjë pak të paduruar.



**SHIGJETARI**
Një lidhje e gjatë ka filluar t’ju bezdisë. Merrni kohën e nevojshme dhe bisedoni me partnerin tuaj dhe çdo gjë do të rregullohet.



**BRICJAPI**
Një konfigurim pozitiv siguron dialog dhe ngrohtësi në jetën e atyre që janë çift. Disa takime premtuese janë në horizont nëse jeni duke kërkuar dashuri.



**UJORI**
Ndaloni melankolinë, pasiguritë dhe bëhuni gati të njihni fytyra dhe vende të reja. Le të flasim për dashurinë.



PESHQIT
Kjo do të jetë një ditë e favorshme e cila do t’ju lejojë të kujdeseni për veten dhe miqtë tuaj.

# Nënë për herë të parë, Dulce Maria zbulon gjininë e fëmijës



Pak kohë më parë aktorja e njohur Dulce Maria bëri me dije se është në pritje të një fëmije. Ndërkohë së fundmi, aktorja ka zbuluar edhe gjininë e fëmijës. Aktorja 34-vjeçare ka postuar një video në rrjetet sociale, ku shfaqet me partnerin e saj dhe të dy të lumtur zbulojnë se do të bëhen me një vajzë.



# Fjolla Morina merr dhuratë veturën superluksoze

Fjolla Morina ka pranuar një dhuratë superluksoze. Bëhet fjalë për një veturë të tipit "Audi Q7", e cila e priti atë në vendin ku po pushonte. Këtë gjë këngëtarja e bëri të ditur me anë të disa videove që i postoi në "Instagram", teksa shihet se si mbeti pa tekst kur e pa veturën. "O Zot, befasi!", ka shkruar sipër njërës video që e ndau me ndjekësit, por nuk tregoi se kush fshihet pas kësaj dhurate. Fjolla Morina para pak ditësh bëri të ditur se ka blerë shtëpi të re.

# Genta Ismajli shfaqet për herë të parë me barkun e fryrë




Këngëtarja shqiptare Genta Ismajli është shfaqur për herë të parë me barkun e fryrë në Zvicër. E buzëqeshur e me një fustan të zi, ajo duket shumë elegante, edhe pse është disa muajsh shtatzënë. Fotoja është shkrepur në një dyqan lulesh në Zvicër, ku duket se këngëtarja shqiptare po kalon disa kohë. Kujtojmë se këngëtarja e



njohur para disa muajsh bëri publike lidhjen e saj me biznesmenin turk Hysein Usta.

# Bella Hadidi me poza atraktive, e veshur me kostum shumëngjyrësh



Bella Hadidi kohën e fundit është bërë shumë aktive me publikime në rrjetet sociale, në të cilat merr vëmendje me pozat joshëse. Në fotografitë e fundit, modeluesen e njohur e shohim të veshur me një kostum sportiv shumëngjyrësh dhe këmishë të zezë sipër. Kjo veshje ia theksonte asaj format trupore, ndërsa dukej atraktive si çdoherë, duke marrë rreth një milion pëlqime për pak orë në "Instagram". Bella Hadidi kohën e fundit duket se është përqendruar më shumë në profesion, andaj nuk është përfolur për ndonjë romancë.




Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

# Rexha: Mund ta eliminojmë Sileksin




Sulmuesi Kastriot Rexha është optimist se Drita ka potencial të mjaftueshëm për ta eliminuar skuadrën e Sileksit nga Liga e Evropës. "Jemi duke u përgatitur mirë për këtë ndeshje mjaft të rëndësishme për ne. Po ashtu, kemi mbajtur në Shqipëri karantinë dhe kemi bërë përgatitje speciale për këtë ndeshje. Kemi parë edhe disa ndeshje të cilat ata kanë zhvilluar dhe mendoj se është e mundur ta kalojmë Sileksin. Skuadra ka treguar performanca të mira dhe do të shkojmë me besim për kualifikim më tutje", ka thënë Rexha

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 15 SHTATOR - Kampionia e Kosovës në futboll, Drita, të enjten do të përballet me skuadrën e Sileksit, në ndeshjen e raundit të dytë eliminator në Ligën e Evropës. Sulmuesi i Dritës, Kastriot Rexha, ka thënë se kampionët e Kosovës e kanë studiuar skuadrën kundërshtare dhe se besojnë se mund ta eliminojnë nga Liga e Evropës. "Jemi duke u përgatitur mirë për këtë ndeshje mjaft të rëndësishme për me. Po ashtu, kemi mbajtur në Shqipëri karantinë dhe kemi bërë përgatitje speciale për këtë ndeshje. Kemi parë edhe disa ndeshje të cilat ata kanë zhvilluar dhe mendoj se është e mundur ta kalojmë Sileksin. Skuadra ka treguar performanca të mira dhe do të shkojmë me besim për kualifikim më tutje", ka thënë Rexha për "Epokën e re".

Ndeshja në mes të skuadrës nga Maqedonia e Veriut dhe Dritës do të zhvillohet të enjten nga ora 20:00 në stadiumin "Todor Proeski" në Shkup me dyer të mbyllura, pa praninë e publikut, për shkak të pandemisë Covid-19. Kjo ndeshje do të transmetohet në televizionin shtetëror të Maqedonisë, pasi marrëveshjes së arritur në mes drejtueseve të televizionit shtetëror dhe skuadrës nga Kratova.

Kampionia e Kosovës ka qenë mjaft aktive në afatin kalimtar, ku ka realizuar pesë transferime, të cilat janë mjaft cilësore. Gjilanasit e kanë rikthyer në Kosovë talentin Festim Alidema, por edhe Aarago Jamal. Përforcimet e tjera janë Ergyn Ahmeti, Vladica Brdarovski dhe Valmir Azemi.

### Të gjithë negativë në testin për koronavirus

Skuadra e Dritës nga Gjilani të martën ka njoftuar se rezultatet për Covid-19 kanë dalë të gjitha negative. Klubi kampion i Kosovës do të përballet më 17 shtator me Sileksin në Ligën e Evropës. "Të hënën klubi ynë u është nënshtruar testeve në prag të ndeshjes me Sileksin në kuadër të Europa League dhe sapo kemi marrë rezultatet e testeve për Covid-19, të gjithë kemi rezultuar negativë. Jemi gati për ndeshje", thuhet në njoftimin e FC Drita.

## SHKURT

### Muriqi prezantohet te Lazio

Sulmuesi i Kosovës, Vedat Muriqi, edhe zyrtarisht i është bashkuar Lazios nga Fenerbahçe, në një marrëveshje rreth 20 milionë euro, duke përfshirë bonuset. Muriqi ka nënshkruar marrëveshje katërvjeçare me Lazion, e cila do ta mbajë atë në Stadiumin Olimpik të kryeqytetit italian deri në verën e vitit 2024. 26-vjeçari do t'i fitojë 2 milionë euro në sezon, plus bonuset. Klubi italian për sulmuesin shtatlartë i pagoi 18 milionë euro skuadrës turke dhe do t'ia paguajë edhe 2 milionë euro të tjera varësisht prej bonuseve të përfshira në marrëveshje.

### Kosova fillon përgatitjet për ndeshjen ndaj Estonisë

Përfaqësuesja e Kosovës te femrat ka filluar përgatitjet për ndeshjen ndaj Estonisë. Përzgjedhësja e Afërdita Fazlija ka mbledhur futbollistet për përgatitje në Obiliq para këtij takimi. Futbollistet "dardane" të martën kanë mbajtur dy seanca stërvitore në stadiumin "Agron Rama" në Obiliq.

### Shtyhet turneu 3x3 i vajzave

Turneu "Women Streetball AA Prishtina" i organizuar nga Klubi i Basketbollit AA (Kerasan) Prishtina në konkurrencën e femrave do të shtyhet për shkak të masave anti-Covid. Federata e Basketbollit e Kosovës ka njoftuar se turneu ka qenë i paraparë të zhvillohet sonte nga ora 17:00 në Marigona Rezidencë në fushën e hapur të basketbollit, megjithatë me rekomandimin e institucioneve shëndetësore është shtyrë për një datë tjetër. Turneu do të shtyhet për një datë tjetër, ku do të njoftojmë me kohë.

### Kumbulla, afër marrëveshjes me Romën

Interesim për Marash Kumbullën që një kohë të gjatë ka shfaqur Interi dhe Lazio por, me sa duket, kjo nuk është një garë dyshe pasi në valle për futbollin e kombëtares shqiptare është futur dhe Roma. Sipas "Sportmediaset", verdhekuqtë janë shumë pranë arritjes së marrëveshjes me Marash Kumbullën. Duke parë vështirësitë për ta rimarrë Smallingun nga Manchester Unitedi, Roma ka kthyer vështrimin nga Kumbulla. Mbrojtësi kuqezi do t'i kushtojë Romës 20 milionë euro.

## Neziri bën një hap para në karrierë




PRISHTINË, 15 SHTATOR - Basketbollisti i talentuar i Kosovës, Leon Neziri, ka bërë një hap para në karrierë. Neziri ka arritur marrëveshje me Universitetin "Plymouth Marjon Uni-Business Sport Management Course", derisa njëkohësisht do të luajë edhe në Plymouth Raiders, që garon në Superligën britanike. Neziri, i cili është paraqitur për grupmoshat e reja të Kosovës, ka folur për aventurën e re. "Kam filluar në Universitetin 'Plymouth Marjon Uni-Business Sport Management Course' edhe jam në skuadrën Plymouth Raiders që luan në British Basketball ligë. Ushtrimet i kemi filluar, kurse edicioni i ri do të fillojë në muajin tetor", ka thënë Neziri për faqen zyrtare të FBK-së. "Unë gjithmonë përpiqem ta jap maksimumin për të arritur atë që dua. Synimet nuk kanë kufi apo limit, megjithatë, gjithmonë pretendoj të arrij sa më lart të mundem. Mendoj se do të kem minuta dhe mundësi ta tregoj veten", ka shtuar Neziri.

# Anulohet turneu 'Lah Nimani'



PRISHTINË, 15 SHTATOR - Federata e Boksit e Kosovës ka njoftuar se turneu tradicional kushtuar legjendës "Lah Nimani" është anuluar. Ky turne ishte paraparë të zhvillohet më 19 dhe 20 shtator, por është anuluar për shkak të koronavirusit. Sipas njoftimit të FBoxK-së, MKRS-ja nuk ka siguruar lejen për mbajtjen e turneut në fjalë.

Federata e Boksit e Kosovës, përkundër përgatitjeve me kohë të organizimit të Turneut Ndërkombëtar 'Lah Nimani', i cili është paraparë të mbahej më 19-20 shtator në Prishtinë, anulon turneun për kohë të pacaktuar. FBoxK-ja ka bërë kërkesë më 31 gusht 2020 në Ministrinë për Kulturë, Rini e Sport për të marrë lejen e organizimit të turneut, gjithnjë duke zbatuar me përpikëri në protokollet përkatëse të dala nga Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti Kombëtar Shëndetësor (IKSHPK), në lidhje me pandeminë Covid-19. Përkundër pritjeve dhe kontakteve të vazhdueshme, MKRS-ja nuk ishte në gjendje të na garantonte lejen, duke hedhur përgjegjësinë në MSh dhe IKShPK, për çka detyrohemi për herë të tretë të mos e mbajmë turneun ndërkombëtar 'Lah Nimani'", thuhet në njoftimin e Federatës së Boksit. "FBoxK-ja konsideron se IKShPK-ja dhe MSh-ja janë përgjegjëse për dhënien e masave mbrojtëse ndaj Covid-19, ndërsa MKRS-ja në konsultim me Komitetin Olimpik të Kosovës, duhet ta marrin vendimin për zhvillimin e aktiviteteve sportive", thuhet në njoftimin e FBoxK-së.

Shtetet si Bullgaria, Shqipëria, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut janë njoftuar për anulimin e turneut "Lah Nimani". Federata e Boksit e Kosovës ka kërkuar që të zhvillohen aktivitetet në boks ashtu sikurse në Evropë.

# Gjici: Kukësi do të luajë vetëm për fitore ndaj Wolfsburgut




KUKËS, 15 SHTATOR - Kur shorti njohu Kukësin me kundërshtarin e saj në turin e dytë të Ligës së Evropës, Wolfsburgu, thuajse të gjithë tifozët shqiptarë në përgjithësi dhe kuksianë në veçanti ishin të dorëzuar. Dallimet janë shumë të mëdha mes një ekipi shqiptar dhe atij në Bundesligë, por nga ana tjetër është mëkat që t'i shohësh verilindorët të eliminuar, duke parë performancën e tyre fantastike ndaj Slavias së Sofias në krye me Gegën. Gjithsesi fati vendos në këtë rrugëtim dhe këtë herë nuk ishte me Kukësin. Por nga ana tjetër Safet Gjici mund të jetë i vetmi që flet për fitore te verilindorët. Në një prononcim për "Procesi Sportiv" vazhdon të jetë po aq i bindur mbi idenë e tij. "Pa diskutim që Wolfsburgu dihet se kush është, por në fushë janë 11 me 11 lojtarë. Ne futemi gjithmonë për fitore. Ia njohim aftësitë dhe gjithë cilësitë, por në fushë ekipet kanë treguar vlera të barabarta. Shembull Tirana dhe Zvezda kishin të njëjtin nivel dhe Tirana mund të fitonte me pak fat. Kjo do të thotë se Kukësi luan për të fituar, pastaj fusha do të flasë vetë. Stafi i ekipit po e përgatit këtë ndeshje për të marrë një rezultat pozitiv", u shpreh Gjici.

## SHKURT

### 'Forbes' zbulon 10 futbollistët që kanë fituar më shumë në vitin e fundit

Revista amerikane e biznesit "Forbes" ka publikuar listën me 10 futbollistët që kanë fituar më shumë gjatë një viti kalendarik, ku përfshihen jo vetëm pagat nga klubet, por edhe të ardhurat nga sponsorë të tjerë. Lista kryesohet nga ylli argjentinas Lionel Messi, që ka arkëtuar rreth 107 milionë euro brenda një viti kalendarik, teksa pak më shumë se gjysmën e kësaj shifre e merr si pagë vjetore nga klubi i Barcelonës. I dyti në listë është ylli portugez Cristiano Ronaldo me 98 milionë euro të ardhura vjetore, nga të cilat 1/3-a është pagë e marrë te klubi i Juventusit, ndërsa pjesa tjetër janë të ardhura nga sponsorët, të cilët CR7 i ka me shumicë. Podiumi plotësohet nga braziliani Neymar, i cili arkëton rreth 80 milionë euro në vit, ndërsa në listë janë bërë pjesë edhe sulmuesi polak i Bayernit, Robert Lewandowski, e portieri spanjoll David De Gea.

### Bale refuzon Unitedin

Gareth Bale pritet të largohet nga Real Madridi, kurse Manchester Unitedi ka shfaqur interesim për ta marrë në formë huazimi. "Djajtë e kuq" nuk janë gati t'i ofrojnë kontratë afatgjatë, pasi në verën e ardhshme synojnë ta rrëmbejnë sulmuesin e Borussia Dortmundit, Jadon Sancho. "The Sun" shkruan se Bale nga krahu tjetër nuk dëshiron një huazim të tillë. Ai dëshiron të ketë një kalim përfundimtar në skuadrën e Manchesterit.

### Werneri: Nuk kisha parë mbrojtës kaq të gjatë

Skuadra e Chelseat të hënën e mposhti Brighton Albionin (1-3), në ndeshjen e parë për edicionin e ri në Premierë Ligë. Në këtë ndeshje debutuan dy transferimet e reja të Chelseat, Timo Werner dhe Kai Havertz. "Unë kurrë nuk kisha luajtur kundër tre mbrojtësve si ata të Brightonit. Ata ishin të mëdhenj, të gjatë pak a shumë si mur", ka thënë Werner.

### Barça, Suarezit: Largohu ose përfundon në tribuna

Raportet në mes të Barcelonës dhe Luis Suarezit janë mjaft të tensionuara, pasi futbollisti nuk bën pjesë në planet e trajnerit Ronald Koeman, por njëkohësisht nuk pranon prishjen e parakohshme të kontratës që skadon verën e ardhshme. Sulmuesi nga Uruguai është gati të heqë dorë nga kontrata vetëm nëse merr rrogën edhe për sezonin e ardhshëm, por kjo ka acaruar jo pak drejtuesit e Barcelonës, të cilët e kanë kërcënuar Suarezin se do ta lënë një vit në tribunë nëse nuk pranon largimin.

### Antetokounmpo nis bisedimet për vazhdimin e kontratës me Bucksin

Basketbollisti grek Giannis Antetokounmpo ka nisur bisedimet me drejtuesit e skuadrës së Milwaukee Bucksit për të diskutuar për të ardhmen. Skuadra u eliminua në gjysmëfinalet e "play-off"-it të NBA-së edhe pse kishte rekordin më të mirë të sezonit të rregullt. Lojtari i shpallur MVP sezonin e kaluar nuk ka vendosur ende për të ardhmen e tij edhe pse gjasat janë që ai të qëndrojë te Bucksi. Giannis ka takuar një nga pronarët e klubit, Marc Lasry, për t'i marrë garancitë e duhura për sezonin e ri. Mediat amerikane raportojnë për një rinovim të kontratës, pasi klubi ka premtuar më shumë investime sezonin e ri, për të sjellë një ose dy lojtarë të mëdhenj. Gjithsesi, palët do të bisedojnë sërish javën e ardhshme, pasi basketbollisti është me pushime. Antetokounmpo ka mundësinë që të firmosë një kontratë pesëvjeçare me Bucksin, me një super-rinovim (240 milionë për pesë sezonet e ardhshme). Në të kundërt, në fund të sezonit të ardhshëm ai do të jetë "free agent" (lojtar i lirë) për të shkuar kudo.

RTK
RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

**Në bazë të Nenit 35 të Ligjit për Radio Televizionin e Kosovës Nr. 04/L-046, RTK rishpallë:**

## KONKURS

**Për plotësimin e pozitës:**

### Drejtor i RTK – TV

**Drejtori i RTK – TV:**

- Drejtori i RTK - TV duhet të jetë person me përvojë të gjerë të menaxhimit të medieve apo fushave të tjera relevante;
- Drejtori i RTK - TV duhet të jetë shtetas i Kosovës dhe me vendbanim të përhershëm në Kosovë;
- Drejtori i RTK - TV emërohet nga Bordi i Drejtorëve, përmes konkursit publik dhe në bazë të rekomandimit të Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së;

**Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:**

- Menaxhimi i veprimtarisë së RTK-TV, në pajtim me Ligjin e RTK-së, Statutin e RTK-së, dhe Kodin Etik të RTK-së;
- Administrimi dhe menaxhimi i RTK-TV, duke siguruar funksionim efektiv dhe efikas;
- Përgatitja e planit vjetor programor, i cili përmban vëllimin edhe strukturën e programit dhe është në përputhje me mundësitë financiare të RTK-së;
- Përgatitja e raportit vjetor mbi përmbushjen e planit programor për nivelin e shikueshmërisë së RTK-TV, posaçërisht për emisionet e reja;
- Planifikimi, organizimi dhe mbikëqyrja e procesit të punës në njësinë programore të RTK-TV;
- Përgjegjës për transmetimin e programit në tërësi si dhe për transmetimin e reklamave sipas kornizës ligjore;
- Mbikëqyrja e përmbushjes së planit programor me numër minimal të ekzekutuesve;
- Mbikëqyrja e arsimimit dhe zhvillimit të kuadrove të reja me perspektivë;
- Zhvillimi i bisedave të rregullta vjetore në njësitë programore;
- Udhëheqja dhe përfaqësimi i njësive programore të RTK-TV;
- Përgatitja e normativave dhe standardeve programore;
- Përgatitja e strategjive zhvillimore për njësitë programore të RTK-TV;
- Sigurimi i cilësisë programore sipas strukturës së programit të përcaktuar me ligj;
- Përcjellja e menaxhimit të mjeteve financiare për çdo emision, duke përllogaritur çmimin për një minutë të programit;
- Organizimi, përpilimi dhe nënshkrimi i të gjitha dokumenteve mbi afarizmin financiar të njësisë programore të RTK-TV, përfshirë edhe pagesën e punës me honorar;
- Përgatitja e emisioneve të reja me shkallën paraprakisht të përcaktuar të shikueshmërisë;
- Vlerësimi i shikueshmërinë dhe statistikave programore;
- Mbikëqyrja e arkivimit të materialit programor;
- Kryerja e punëve të tjera sipas kërkesës së Drejtorit të Përgjithshëm.

I punësuari për punën e vet në cilësinë e Drejtorit të RTK -TV i përgjigjet dhe i raporton Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së dhe Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm.

**Kushtet që duhen plotësuar:**

- Kualifikim superior profesional në drejtimin përkatës;
- Të paktën 5 vjet përvojë pune në menaxhimin e mediave apo fushave të tjera relevante (Përparësi kanë kandidatët me përvojë më të gjatë);
- Të jetë person me integritet të lartë personal dhe moral;
- Të ketë njohuri të shkëlqyeshme të spektrit medial në Kosovë, regjion dhe më gjerë;
- Të ketë aftësi të dëshmuara në organizim, udhëheqje dhe planifikim;
- Aftësi udhëheqëse dhe komunikuese;
- Standard të lartë të gjuhës shqipe në të folur dhe në të shkruar;
- Njohje të gjuhës serbe dhe të gjuhës angleze;
- Aftësi për caktimin e prioriteteve dhe për të punuar në mënyrë efikase nën presion;
- Të mos ketë dëshmuar përkatësi partiake;
- Njohuri e programeve MS Word, Excel dhe të tjera;
- Aftësi për të bashkëvepruar me maturi dhe ndjeshmëri me kolegë dhe palë;
- Përkushtim ndaj shërbimit publik të transmetimeve.

Në bazë të Ligjit për RTK-në, Drejtor i RTK-TV nuk mund të emërohet personi, i cili:

a) mban post publik te zgjedhur (funksionarët publik);
b) ka qenë deputet, ministër, zyrtarë i lartë i pushtetit qendror apo lokal, apo anëtarë i forumeve drejtuese të subjekteve politike gjatë tri (3) viteve të fundit;
c) ka interes financiar të drejtpërdrejtë ose indirekt në biznesin e medieve dhe reklamave ose
d) është dënuar pas procesit të rregullt, për vepër penale e cila është e dënueshme mbi gjashtë (6) muaj burg.

Kandidatët duhet të dorëzojnë:

- një CV,
- një kopje të letërnjoftimit,
- një letër motivuese,
- tri referenca,
- dëshmitë e kualifikimit,
- dëshmi që nuk është nën hetime, të lëshuar gjatë muajit të fundit para aplikimit, si dhe
- aplikacionin, i cili duhet të shkarkohet nga web faqja e RTK-së, www.rtklive.com.

Bashkëngjitur me këtë dokumentacion, kandidati duhet të dorëzojë edhe një projekt lidhur me synimet zhvillimore të RTK - TV (deri në 3 faqe).

Dokumentacioni i kompletuar duhet të dorëzohet i skenuar, në mënyrë elektronike, përmes internet adresës konkurs@rtklive.com, deri më datë 30.09.2020 në orën 16:00.

**Vetëm aplikacionet dhe dokumentet e dorëzuara përmes postës elektronike do të pranohen.**

**Aplikacionet e dërguara me vonesë nuk do të pranohen.**

**Aplikacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.**

RTK
RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

**Na osnovu člana 35 Zakona o Radio Televiziji Kosova Br. 04/L-046, RTK ponovno objavljuje:**

## KONKURS

**Za popunjavanje pozicije:**

### Direktor RTK – TV

**Direktor RTK - TV:**

- Direktor RTK - TV kanala treba da je osoba sa velikim iskustvom u rukovođenju medijima ili relevantnim oblastima;
- Direktor RTK - TV kanala treba da je državljanin Kosova, sa stalnim boravkom na Kosovu;
- Direktora RTK - TV kanala imenuje Upravni Odbor RTK-a, putem javnog konkursa i na osnovu predloga generalnog direktora RTK-a.

**Glavni zadaci i odgovornosti:**

- Rukovodi delatnostima RTK –TV kanala, u skladu sa zakonom o RTK-u, Statutom i etičkim kodom RTK-a;
- Upravlja RTK – TV kanalima, obezbeđujući efikasno funkcionisanje;
- Priprema godišnji programski plan koji je sveukupan u strukturi programa i u skladu je sa finansijskim mugućnostima RTK-a;
- Priprema godišnji izveštaj o sprovođenju plana i programa, o nivou gledanosti televizijskih programa, naročito novih emisija;
- Planira, organizuje i nadgleda radni proces u programskim jedinicama RTK – TV kanala;
- Odgovoran je za emitovanje programa u celini, kao i za emitovanje reklama u zakonskim okvirima;
- Nadgleda sprovođenje plana i programa sa najmanjim mogućim brojem radnika;
- Nadgleda obrazovanje i novi razvojni kadar sa perspektivom;
- Obavlja redovne godišnje razgovore u programskim jedinicama;
- Upravlja i predstavlja televizijske programske jedinice RTK – TV kanala;
- Priprema norme i programske standarde;
- Priprema razvojnu strategiju televizijskih programskih jedinica RTK – TV kanala;
- Osigurava kvalitet programa prema programskoj strukturi određenoj zakonom;
- Prati upravljanje finansijskim sredstvima za svaku emisiju, izračunavajući cenu po minutu programa;
- Organizuje izradu i potpisuje sva dokumenta o finansijskom poslovanju televizijskih programskih jedinica RTK – TV kanala, obuhvatajući i plaćanje honorarnog rada;
- Priprema nove emisije sa prethodno izračunatim stepenom gledanosti;
- Ocenjuje gledanost i programsku statistiku;
- Nadgleda arhiviranje programskog materijala;
- Izvršava i druge zadatke na osnovu zahteva generalnog direktora RTK.

Zaposleni u svojstvu direktora RTK – TV kanala, za svoj rad izveštava i odgovara generalnom direktoru RTK-a i zam. generalnog direktora RTK-a.

**Neophodni uslovi:**

- Visoka stručna sprema u relevantnoj oblasti;
- Najmanje 5 godine iskustva u rukovođenju medijima i ostalim relevantnim poljima (prednost imaju kandidati sa dužim iskustvom);
- Osoba sa visokim profesionalnim i moralnim integritetom;
- Izuzetno poznavanje medijskog spektra na Kosovu, u regionu i šire;
- Dokazane sposobnosti u organizovanju, rukovođenju i planiranju;
- Veštine u rukovođenju i komunikaciji;
- Visoki standard albanskog jezika, govornog i pisanog;
- Poznavanje srpskog i engleskog jezika;
- Sposobnost za određivanje prioriteta i rada na efikasan način i pod pritiskom;
- Ne može imati stranačku pripadnost;
- Odlično poznavanje rada na kompjuteru, posebno programa MS Word, Excel i interneta;
- Sposobnost za timski rad, uz odmerenost i obzirnost prema kolegama i strankama;
- Posvećenost javnom servisu emitovanja.

Na osnovu Zakona o RTK-u, za Direktora RTK-TV, ne može se izabrati osoba, koja:

a) ima izbornu javnu funkciju (javni funkcioneri);
b) je bila poslanik, ministar, visoki službenik centralne ili lokalne vlasti, ili član upravnih foruma političkih subjekata u poslednje tri (3) godine;
c) ima neposredan ili posredan finansijski interes u sferi medija i reklama; ili
d) je osuđena redovnim postupkom za neko krivično delo koje je kažnjivo sa preko šest (6) meseci zatvora.

Kandidati treba da dostave:

a) CV,
b) kopiju lične karte,
c) motivaciono pismo,
d) tri preporuke,
e) dokaze o kvalifikaciji,
f) dokaz da nisu pod istragom, (ne starije od mesec dana od dana apliciranja), kao i
g) formular za prijavu, koji se može preuzeti na web stranici RTK, www.rtklive.com

Uz ovu dokumentaciju kandidati treba da dostave i svoj projekat razvoja RTK-TV kanala (do 3 stranice).

Kompletna dokumentacija se u elektronskom formatu, skenirana, šalje na email adresu: konkurs@rtklive.com, do 30.09.2020. u 16:00h.

**Prihvataju se samo prijave i dokumentacija predati elektronskim putem.**

**Prijave dostavljene sa zakašnjenjem neće biti prihvaćene.**

**Nepotpuna dokumentacija neće biti uzeta u obzir.**

RTK
RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

**Na osnovu člana 35 Zakona o Radio Televiziji Kosova Br. 04/L-046, ponovno objavljuje:**

## KONKURS

**Za popunjavanje pozicije:**

### Direktora RTK – 2 TV

**Direktor RTK – 2 TV:**

- Direktor Kanala RTK 2 - TV treba biti osoba sa velikim iskustvom rukovođenja medijima ili sličnim relevatnim poljima;
- Direktor Kanala RTK 2 - TV treba biti državljanin Kosova i sa stalnim boravkom na Kosovu;
- Direktor Kanala RTK 2 - TV imenjuje se od strane Borda Direktora, putem javnog konkursa uzeći u obzir i predlog Radne grupe za izbor Direktora Televizijskog kanala na srpskom jeziku.

**Glavni zadaci i odgovornosti:**

- Rukovodi delatnostima Kanala RTK 2 - TV, u skladu sa zakonom RTK, Statutom i etičkim kodom RTK;
- Administrira i rukovodi Kanalom RTK 2 - TV obezbeđujući efikasno funkcionisanje;
- Priprema godišnji programski plan koji je sveukupan u strukturi programa i u skladu je sa finansijskim mugućnostima RTK;
- Priprema godišnji izveštaj o ispunjavanju plana i programa o nivou gledanosti televizijskog programa naročito za nove emisije;
- Planira, organizuje i nadgleda radni proces u programskoj jedinici Kanala RTK 2 - TV;
- Odgovoran je za emitovanje programa u celini kao i za emitovanje reklama u zakonskim okvirima;
- Nadgleda ispunjavanje plana i programa sa najmanjim mogućim brojem radnika;
- Nadgleda obrazovanje i novi razvojni kadar sa perspektivom;
- Odvija redovne godišnje razgovore u programskim jedinicama;
- Upravlja i predstavlja televizijske programske jedinice u Kanalu RTK 2 - TV;
- Priprema norme i programske standarde;
- Priprema razvojne strategije za televizijske programske jedinice u Kanalu RTK 2 - TV;
- Osigurava kvalitet programa prema programskoj strukturi određenoj zakonom;
- Prati upravljanje finansijskim sredstvima za svaku emisiju, izračunavajući cenu za jedan minut programa;
- Organizuje izradu i potpisuje sva dokumenta o finanssijskom poslovanju televizijske programske jedinice u Kanalu RTK 2 - TV, obuhvatajući i plaćanje honorarnog rada;
- Priprema nove emisije sa predhodno izračunatim stepenom gledanosti;
- Ocenjuje gledanost i programske statistike;
- Nadgleda arhiviranje programskog materiala;
- Izvršava i druge zadatke na osnovu zahteva Generalnog Direktora RTK.

Zaposleni u svojstvu Direktora Kanala RTK 2 - TV, za svoj rad izveštava i odgovara Generalnom Direktoru RTK.

**Uslove koje treba ispuniti:**

- Vrhunsku profesionalnu kvalifikaciju u relevatnom polju;
- Najmanje 5 godine iskustva u rukovođenju medijama i ostalim relevatnim poljima (Prednost imaju kandidati sa dužim iskustvom);
- Je osoba sa visokim profesionalnim i moralnim integritetom;
- Ima izuzetno znanje medijskog spektra na Kosovu, Regiji i šire;
- Dokazane sposobnosti u organizovanju, rukovodjenju i planiranju;
- Veština u rukovođenju i komunikaciji;
- Visoki standard Srpskog jezika, govornog i pisanog;
- Poznavanje Albanskog i Engleskog jezika;
- Sposobnost za određivanje prioriteta i rada na efikasan način i pod pritiscima;
- Nepripadnost političkim partijama;
- Odlično poznavanje upotrebe kompjutera, posebno programe MS Word, Excel i Interneta;
- Sposobnost za timski rad sa odmerenošću i sa osetljivošću sa kolegama i strankama;
- Posvećivanje oko javnog servisa emitovanja.

Na osnovu Zakona o RTK-u, za Direktora RTK 2 -TV, ne može se izabrati osoba, koja:

- a) ima izbornu javnu funkciju (javni funkcioneri);
- b) je bila poslanik, ministar, visoki službenik centralne ili lokalne vlasti, ili član upravnih foruma političkih subjekata u poslednje tri (3) godine;
- c) ima neposredan ili posredan finansijski interes u sferi medija i reklama; ili
- d) je osuđena redovnim postupkom za neko krivično delo koje je kažnjivo sa preko šest (6) meseci zatvora.

Kandidati treba da dostave:

- Jedan CV,
- Izvod iz matične knjige rođenih,
- Kopija Lične Karte,
- Pismo motivisanja,
- Tri preporuke,
- Dokazi o kvalifikaciji
- Dokaz da nije pod istragom (ne starije od mesec dana od dana apliciranja), kao i
- Molba/aplikacija, koja se može uzeti od web stranice RTK, www.rtklive.com.

U prilogu ove dokumentacije, kandidati treba da dostave i projekat vezan za nastojanja o razvoju Kanala RTK 2 - TV (do 3 stranice).

Kompletna dokumentacija se u elektronskom formatu, skenirana, šalje na email adresu: konkurs@rtklive.com, do 30.09.2020. u 16:00h.

**Prihvataju se samo prijave i dokumentacija predati elektronskim putem.**

**Aplikacije dostavljene sa zakašnjenjem se neće prihvatiti.**

**Nekompletirane aplikacije neće se uzeti u obzir.**

RTK
RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

**Në bazë të Nenit 35 të Ligjit mbi Radio Televizionin e Kosovës Nr. 04/L-046, rishpallë:**

## KONKURS

**Për plotësimin e pozitës:**

### Drejtor i RTK 2 – TV

**Drejtori i RTK 2 – TV:**

- Drejtori i Kanalit RTK 2 - TV duhet të jetë person me përvojë të gjerë të menaxhimit të medieve apo fushave të tjera relevante;
- Drejtori i Kanalit RTK 2 - TV duhet të jetë shtetas i Kosovës dhe me vendbanim të përhershëm në Kosovë;
- Drejtori i Kanalit RTK 2 - TV përzgjidhet dhe emërohet nga Bordi i Drejtorëve, përmes konkursit publik duke marrë në konsiderim rekomandimin e Grupit Punues për Përzgjedhjen e Drejtorit të Kanalit Televiziv në gjuhën serbe.

**Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:**

- Menaxhon veprimtarinë e Kanalit RTK 2 - TV në pajtim me Ligjin e RTK-së, Statutin e RTK-së, dhe Kodin Etik të RTK-së;
- Administron dhe menaxhon Kanalin RTK 2- TV, duke siguruar funksionim efektiv dhe efikas;
- Përgatit planin vjetor programor, i cili përmban vëllimin edhe strukturën e programit dhe është në përputhje me mundësitë financiare të RTK-së;
- Përgatitë raportin vjetor mbi përmbushjen e planit programor për nivelin e shikueshmërisë së programit televiziv, posaçërisht për emisionet e reja;
- Planifikon, organizon dhe mbikëqyr procesin e punës në njësinë programore të Kanalit RTK 2- TV;
- Është përgjegjës për transmetimin e programit në tërësi si dhe për transmetimin e reklamave sipas kornizës ligjore;
- Mbikëqyrë përmbushjen e planit programor me numër minimal të ekzekutuesve;
- Mbikqyrë arsimimin dhe zhvillimin e kuadrove të reja me perspektivë;
- Zhvillon bisedat e rregullta vjetore në njësitë programore;
- Udhëheqë dhe përfaqëson njësitë programore të Kanalit RTK 2- TV;
- Përgatitë normativat dhe standardet programore;
- Përgatitë strategjitë zhvillimore për njësitë programore të Kanalit RTK 2- TV;
- Siguron cilësinë e programit sipas strukturës së programit të përcaktuar me ligj;
- Përcjellë menaxhimin e mjeteve financiare për çdo emision, duke përllogaritur çmimin për një minutë të programit;
- Organizon përpilimin dhe nënshkruan të gjitha dokumentet mbi afarizmin financiar të njësisë programore të Kanalit RTK 2 – TV, përfshirë edhe pagesën e punës me honorar;
- Përgatitë emisionet e reja me shkallën paraprakisht të përcaktuar të shikueshmërisë;
- Vlerëson shikueshmërinë dhe statistikat programore;
- Mbikëqyrë arkivimin e materialit programor;
- Kryen punë të tjera sipas kërkesës së Drejtorit të Përgjithshëm.

I punësuari për punën e vet në cilësinë e Drejtorit të Kanalit RTK 2 – TV i përgjigjet dhe i raporton Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së.

**Kushtet që duhen plotësuar:**

- Kualifikim superior profesional në drejtimin përkatës;
- Të paktën 5 vjet përvojë pune në menaxhimin e mediave apo fushave të tjera relevante (Përparësi kanë kandidatët me përvojë më të gjatë);
- Të jetë person me integritet të lartë personal dhe moral;
- Të ketë njohuri të shkëlqyeshme të spektrit medial në Kosovë, regjion dhe më gjerë;
- Të ketë aftësi të dëshmuara në organizim, udhëheqje dhe planifikim;
- Aftësi udhëheqëse dhe komunikuese;
- Standard të lartë të gjuhës serbe në të folur dhe në të shkruar;
- Njohje të gjuhës shqipe dhe të gjuhës angleze;
- Aftësi për caktimin e prioriteteve dhe për të punuar në mënyrë efikase nën presion;
- Të mos ketë dëshmuar përkatësi partiake;
- Njohuri e programeve MS Word, Excel dhe të tjera;
- Aftësi për të bashkëvepruar me maturi dhe ndjeshmëri me kolegë dhe palë;
- Përkushtim ndaj shërbimit publik të transmetimeve.

Në bazë të Ligjit për RTK-në, Drejtor i RTK 2 - TV nuk mund të emërohet personi, i cili:

a) mban post publik te zgjedhur (funksionarët publik);
b) ka qenë deputet, ministër, zyrtarë i lartë i pushtetit qendror apo lokal, apo anëtarë i forumeve drejtuese të subjekteve politike gjatë tri (3) viteve të fundit;
c) ka interes financiar të drejtpërdrejtë ose indirekt në biznesin e medieve dhe reklamave ose
d) është dënuar pas procesit të rregullt, për vepër penale e cila është e dënueshme mbi gjashtë (6) muaj burg.

Kandidatët duhet të dorëzojnë:

- një CV,
- një certifikatë të lindjes,
- një kopje të letërnjoftimit,
- një letër motivuese,
- tri referenca,
- dëshmitë e kualifikimit,
- dëshmi që nuk është nën hetime, të lëshuar gjatë muajit të fundit para aplikimit, si dhe
- aplikacionin, i cili duhet të shkarkohet nga web faqja e RTK-së, www.rtklive.com.

Bashkëngjitur me këtë dokumentacion, kandidati duhet të dorëzojë edhe një projekt lidhur me synimet zhvillimore të Kanalit RTK 2 - TV (deri në 3 faqe).

Dokumentacioni i kompletuar duhet të dorëzohet i skenuar, në mënyrë elektronike, përmes internet adresës konkurs@rtklive.com, deri më datë 30.09.2020 në orën 16:00.

**Vetëm aplikacionet dhe dokumentet e dorëzuara përmes postës elektronike do të pranohen.**

**Aplikacionet e dërguara me vonesë nuk do të pranohen.**

**Aplikacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.**

RTK
RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

**Në bazë të Nenit 35 të Ligjit mbi Radio Televizionin e Kosovës Nr. 04/L-046, RTK rishpallë:**

## KONKURS

**Për plotësimin e pozitës:**

### Drejtor i RTK Radios

**Drejtori i RTK Radios:**

- Drejtori i RTK Radios duhet të jetë person me përvojë të gjerë të menaxhimit të medieve apo fushave të tjera relevante;
- Drejtori i RTK Radios duhet të jetë shtetas i Kosovës dhe me vendbanim të përhershëm në Kosovë;
- Drejtori i RTK Radios emërohet nga Bordi i Drejtorëve, përmes konkursit publik dhe në bazë të rekomandimit të Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së;

**Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:**

